PAQJA



REVISTË PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË

Viti VI. Nr. 53. 19 prill - 19 maj 2011. Organ i Shoqatës Kulturore "Zëri Ynë" Çmimi 0.80€



Editorial
DEUS EX MACHINA

Brendon Berisha
TË SËMURËT MENTALË, PA PËRKUJDESJE DHE NË RRUGË

Qëndresë Mustafa
KËRKOHET NDRYSHIMI I KUSHTETUTËS SË KOSOVËS



Intervistë me ministrin e jashtëm, Enver Hoxhaj

HOXHAJ: PËR KOSOVËN LOBIM DHE PËRMIRËSIM TË IMAZHIT


MREKULLITË E KUR'ANIT
SUKSESI I GARANTUAR



FILOZOFIA JONË
Islami
besim, ligj, kulturë dhe qytetërim


JETA DHE VDEKJA
E MIRA DHE E KEQJA


VIOLETË KOKOLLARI
SHPRESA RILIND


Flamur Maloku
Shtresimet e tekstit


Blerim HALILI
Çasti bën Çudira


SYHEJL HAVOLLI
LITAR LOTËSH



Sadbere Hashani
Fitorja është imja



MILAZIM KRASNIQI
VEPRA
DRAMA


Milazim KRASNIQI
NË ÇFARË KOSOVE DO TË JETOJMË
SPROVA E NJË GAZETARIE KOMENTUESE


Nexhat Ibrahimi
Aspekte të marrëdhënieve islamo-kristiane në Mesjetë


Milazim KRASNIQI
E vërteta e Islamit ndër shqiptarë


TË TJERËT për ISLAMIN
Ajni Sinani


Grup autorësh
HUTBE
Ramazani


ISLAMI I KEQKUPTUAR DHE FATKEQËSIA BOTËRORE
Dr. Milazim Krasniqi


Kronologji e Historisë Islame


Zëri Ynë
SHOQATA KULTURORE

përmbajtja


7 Regjistrim pas 30 vitesh


14 FMN-ja sikurse uji i detit


16 Maqedonai në prag të zgjedhjeve...


26 Muavije ibën ebi Sufjan


32 Astma bronkiale

Portreti i muajit: Presidente konsensuale 2

Avni Avdiu: Deus ex machina 3

Qëndresë Mustafa: Kërkohet ndryshimi i Kushtetutës së Kosovës 4-5

Mr. sc. Flamur Hyseni: Sfidat e kushtetutshmërisë .. 5-6

Gëzim Qerimi: Regjistrim pas 30 vitesh 7

Përparim Bublaku: Viti 2010 me 210 aborte 8

Brendon Berisha: Të sëmurët mentalë, pa përkujdesje dhe në rrugë... 9

Astrit Veliqi: Pusetat - rrezik për jetën e qytetarëve 10-11

Lulzim Ahmeti: Dodmosdoshmëria për rezerva shtetërore 12

Fatos Shala: Pak interesim për turizmin 13

Osman D. Gashi: FMN-ja sikurse uji i detit 14

Adelina Avdullahu: "Euroskeptikët e rinj" 15

Musa Llamallari: Maqedonia në prag të zgjedhjeve të parakohshme.. 16-18

Intervistë me ministrin e jashtëm, Enver Hoxhaj . 19-21

Muhamet Jahiri: Shqiptarët shembull i tolerancës dhe diversitetit ndërfetar............................ 22-23

Ndriçim Hoxhaj: Restaurohet Muzeu i Pavarësisë .. 24

Albert Ahmeti: Paqja Studentore zgjodhi kryetarin e ri 25

Muhamed J. Kajolli: Muavije ibën ebi Sufjan ... 26-28

John Esposito: Demaskimi i mitit të 'Euarabisë'... 29

Arsim Jonuzi: Midis autoritarizmit dhe Islamit .. 30-31

Dr. Ali Iljazi: Astma bronkiale 32

Artan Bejta & Jehona Sahiti: "Pika në tru" sëmundje dramatike me pasoja fatale 33-35

Adil Olluri: Shkrimtari postmodern 36-37

Naser Shatrolli: 50-vjet moral artistik 37

Poezi 38

Alban Bilalli: Para se të nisë ndeshja, lexon Kuran.. 38

Intervistë me Fadil Vokrrin........................... 39-40



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti VI / Nr. 53
19 prill - 19 maj 2011
Botues
Zëri Ynë
0.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor
Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës
Avni AVDIU
avni.avdiu@gmail.com

Redaktor i kulturës
Flamur MALOKU
flamurmaloku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
Osman D. GASHI
osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore
Mimoza SINANI

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@hotmail.com
http://www.zeri-yne.org

Adresa:
Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14, përballë teatrit Dodona, Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

PRESIDENTE KONSENSUALE

Parlamenti i Kosovës zgjodhi udhëheqëse të vendit Atifete Jahjagën - një komandante policie, duke shmangur kështu zgjedhjet e reja pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila kontestoi ligjshmërinë e zgjedhjes së Behgjet Pacollit. Gjatë konferencës së përbashkët për mediat, të kryeministrit Thaçi, Isa Mustafës, Behgjet Pacollit dhe ambasadorit Christopher Dell, presidenti i deritanishëm i vendit, Pacolli theksoi se nuk do të rikandidojë për këtë post dhe se, sipas tij, nuk ka pasur asnjë presion as nga kryeministri Thaçi, e as nga ambasadori Dell për këtë vendim.

Marrëveshja e arritur ndërmjet Pacollit, Mustafës e Thaçit, është kjo:

"Ne nominojmë Atifete Jahjagën kandidate për presidente të Kosovës. Pajtohemi që menjëherë të formojmë një komision për reformën e zgjedhjeve presidenciale, në mënyrë që presidenti të zgjidhet drejtpërdrejt nga populli. Komisioni duhet ta përfundojë punën nga 6 – 9 muaj. Zgjedhjet do të mbahen jo më vonë se 6 muaj pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese lidhur me zgjedhjen e presidentit nga populli".

Sipas këtij memorandumi do të formohet edhe komisioni përkatës për ndryshimin e ligjit zgjedhor dhe që zgjedhjet e reja parlamentare dhe ato lokale të mbahen në vitin 2013.

Ajo është vetëm një vit më e madhe se sa minimumi i moshës për të mbajtur këtë post të rëndësishëm për një shtet në zhvillim si Kosova. Në tri vjet pavarësi, Atifete Jahjaga është e para femër që do të udhëheqë vendin. Mori mbështetjen për presidente të Kosovës nga tri partitë politike PDK, LDK dhe AKR, pas tri ditësh bisedime për dalje nga kriza politike. Mbi bazën e marrëveshjes së nënshkruar nga forcat politike të koalicionit qeveritar PDK-AKR dhe LDK, Jahjaga do të drejtojë vendin deri në ndryshimet kushtetuese, të cilët do të mundësojnë votën direkt për postin e presidentit. Jakup Krasniqi dhe Lëvizja Vetëvendosje kanë paralajmëruar se do të paraqesin iniciativën në Gjykatën Kushtetuese, për të shqyrtuar zgjedhjen e presidentes së re të Kosovës, Atifete Jahjaga. Nga kabineti i Krasniqit është thënë se ambasadori amerikan, Christopher Dell, e ka detyruar Hashim Thaçin, Isa Mustafën dhe Behgjet Pacollin, të nënshkruajnë marrëveshjen për tejkalimin e krizës institucionale në Kosovë, e cila është drejtpërsëdrejti në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës për zgjedhjen e Presidentit. Mirëpo, për ta dërguar një lëndë në Gjykatën Kushtetuese, nevojiten së paku 30 nënshkrime deputetësh.

"Si presidente e vendit, unë do të jem garantuese e kushtetutës dhe ligjit, një faktor unifikues, politikisht neutral dhe do t'i mbrojë interesat e Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur, do të jem përfaqësuese e të gjithë qytetarëve, pavarësisht kombësisë, fesë, racës e gjinisë", - ka thënë Jahjaga gjatë fjalës së saj para deputetëve.



BIOGRAFIA: **Atifete Jahjaga** u lind më 20 prill 1975 në Gjakovë, ndërkaq shkollimin fillor, atë të mesëm dhe studimet në Fakultetin Juridik i kreu në Prishtinë.

Duke hulumtuar mbi jetën e saj në jetën publike dhe përditshmërinë kosovare, mësojmë se Atifete Jahjaga është vajza e Brahim Bajram Agës nga fshati Ratkovc i Gjakovës dhe se ajo rrjedh nga familja e Agës së Ratkovcit, familje me emër në Malësinë e Gjakovës. Kjo familje e ka prejardhjen nga fshati Tetaj (Rrucaj) i krahinës Nikaj Mërtur (komuna Lekbibaj) të Tropojës. Në Bajram Curr përflitet se gjyshi i Atifetes ka zbritur nga malësia në fillimin e shekullit të kaluar, në vitet 1910-1912, duke u vendosur si shumë familje të tjera nga kjo krahinë, në rrethinat e Gjakovës, për arsye hasmërie. Prejardhjen e saj nga Nikaj Merturi, Atifetja e ka shprehur edhe vetë në biseda gjatë vizitave në qytetin Bajram Curr. Si juriste e diplomuar nga Universiteti i Prishtinës doli në vitin 2000, ndërkaq më vonë përfundoi edhe studimet në Universitetin e Mançesterit në Angli, certifikimin postdiplomik në menaxhimin policor dhe të drejtës penale në vitin 2006/2007. Karrierën e saj e nisi në Policinë e Kosovës, duke u angazhuar në të gjitha çështjet e policisë dhe në të gjitha profilet, duke nisur nga patrullimi, hetuesia e deri te zëvendësdrejtore e parë e Policisë së Kosovës. Ka gradën e koloneles dhe është pranuar në Policinë e Kosovës menjëherë pas themelimit të saj. Deri më tash ka kryer mjaft detyra dhe specializime, si në vend ashtu edhe jashtë vendit. Ka qenë në specializim në fushën e sigurisë edhe në SHBA. Tani vijon studimet e magjistraturës në shkencat kriminalistike në Prishtinë. Është e martuar me Astrit Kuçin. Nuk ka fëmijë. Si kadete e dalluar, u përzgjodh për takim me presidentin e atëhershëm amerikan, George W. Bush, me rastin e një vizite që ai i bëri Akademisë.



DEUS EX MACHINA

Avni AVDIU

Mosmarrëveshjet janë bërë përditshmëri. Më të theksuara duken në rrafshin politik për faktin se mediat ushqehet me to. Zaten po të mos ishin ato, çfarë do të bëhej?! Nganjëherë qytetarët po i harrojnë edhe problemet e tyre, duke u marrë me problemet e partive e politikanëve. Po qe se nisemi nga thënia 'merrja bukën e harrojnë djathin!', efekti tashmë është arritur. Konkretisht në vend se epiqendër e debateve të ishte përmirësimi i jetës së qytetarëve, gjetja e rrugëzgjidhjeve për problemet e shumta si dhe avancimi i imazhit të vendit në arenën ndërkombëtare, na kalon koha duke u marrë me çështje triviale. Jemi mësuar që ta ngushëllojmë veten se kështu ndodh gjithkund, e veçmas në hapësirat ballkanike, por realiteti dëshmon se pikërisht shqiptarët janë bërë nyja gordiane e vetvetes, duke shkaktuar gjithandej 'ngërç politik' për veten e tyre.

Mosmarrëveshje në Shqipëri…
Mosmarrëveshje në Kosovë…
Mosmarrëveshje në Maqedoni…

Është kjo motoja e rutinës monotone, që po përshkon kombin, është vetë kutia e hapur e Pandorës, të cilën zor se do ta mbyllë kush.

Në Kosovë Gjykata Kushtetuese përpiqet ta tregojë drejtësinë, shumë diskutabile, të ardhur me hir o me pahir si derivat i një pakoje, të kodifikuar ngutshëm me ligje herë-herë kontradiktore për ta tejkaluar një gjendje të caktuar, e cila ishte e padurueshme. Dhe gjersa janë shtuar zërat për vakuumet që u prodhuan nga vetë çelësi i supozuar i zgjidhjeve, këtë opozita orvatet ta shfrytëzojë më së 'miri', duke e 'respektuar' kushtetutën që më parë e kontestonte.

Dhe rrjedhimisht vendi u ndodh në një qorrsokak, pa dalje, por edhe pa kthim të sigurt. Edhe po qe se eventualisht zgjidhja kërkohej përmes zgjedhjeve, prapëseprapë rrëfimi fillonte aty edhe ku do të përfundonte, pra çka nëse rezultati zgjedhor do të ishte i njëjtë?!

Asgjë hiç, përveçse sërish avazi i vjetër….

Dilemat e këtilla, s'di sa llogariteshin, por ajo që shihej qartë e hapur ishte një etje e madhe për improvizim krizash.

Të gjithë shtrojnë kushte: 'o kështu, o s'bën ndryshe'. Është botë kushtëzimesh, dhe jo vetëm politike, kushtëzime këto që nuk shkojnë përtej rrethit të ngushtë: 'ne nuk luajmë nga ky pozicion, pa çka se pala tjetër nuk pajtohet'.

Dhe befas vjen zgjidhja. Si zakonisht nga jashtë. Deus ex machine në zarf. Ambasadori amerikan Kristofer Dell e kishte këtë makinë-zarf në dorë. Në konferencën e përbashkët për shtyp, me liderët e partive PDK, LDK dhe AKR, ai në mes të tjerash tha (parafrazoj): 'Sot kur është zgjuar Atifetja s'ka mund ta paramendojë as si ëndërr se sot bëhet presidente. Por sot u bë'. Pra, me këtë deshi të thotë se të gjithë do të çuditeni, por më së shumti do të çuditet presidentja e re. Kjo nuk ishte përralla e zotit Dell për Lizën në botën e çudirave, por ishte realiteti për Atifeten në botën e çudirave. Kështu në këtë botë të çudirave në Kosovë, dues ex machine në zarf, vendosi në momentet kur partitë dhe politikanët nuk ishin në gjendje as të merren vesh e as të vendosin për asgjë në interes të përbashkët të vendit. I revoltuar kryeparlamentari J. Krasniqi u prononcua se police në krye të vendit vendoset vetëm në kohë puçi dhe u shpreh se edhe me rastin e zgjedhjes së presidentes së re është shkelur kushtetuta.

Megjithatë, prapëseprapë mbetet për t'u shpresuar se zgjidhja që ka ofruar ambasadori amerikan ka qenë dashamirëse në momentet kur mosmarrëveshjet thelloheshin dhe vendi shkonte në udhë pa krye.

Mirëpo çfarë të thuhet për një dues ex machine tjetër. Ajo që paralajmërohet nga UE. Ministri i jashtëm sllovak Miroslav Lajçak, vendi i të cilit është deklaruar se nuk do ta njohë kurrë pavarësinë e Kosovës dhe se do ta mbështesë Serbinë në raport me Kosovën, pritet ta zëvendësojë përfaqësuesin e ICO-s, Piter Fejt-in, pas skadimit të mandatit këtë muaj. Lajçak, të cilin UE e dërgoi edhe në Shqipëri si të deleguar special për ndërmjetësim mes PS dhe PD, shihet si mundësi për të ardhur edhe në Kosovë për ta drejtuar misionin e Bashkimit Evropian. 'Ndoshta Europa ka gjetur dues ex machine adekuate për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tona'. ■

KËRKOHET NDRYSHIMI I KUSHTETUTËS

Qëndresë MUSTAFA

Në trevjetorin e miratimit të Kushtetutës së Kosovës, ekspertët e kësaj fushe kanë thënë se Kosova ka nevojë të rishkruajë një kushtetutë të re, e cila nuk i pengon proceset politike dhe ekonomike të shoqërisë. Sipas tyre, Kushtetuta e vendit nuk i plotëson të gjitha nevojat e qytetarëve të Kosovës dhe, si e tillë, duhet të ripërpunohet në mënyrë që të eliminohen vetitë negative dhe kontradiktore që u promovuan gjatë këtyre tri viteve. Njohësit e kushtetutës kanë pohuar se akti më i lartë juridik ka ndikuar negativisht edhe në mos shtrirjen e sovraniteti në tërë territorin e Kosovës.

Ekspertët e kësaj fushe, ndër të tjerash, kanë theksuar se Kushtetuta e Kosovës ka nevojë për amendamentimin e nenit 86, që ka të bëjë me zgjedhjen e presidentit dhe nenit 4 i cili, sipas tyre, duhet të precizojë që Kosova është shtet demokratik me një sistem të qeverisjes parlamentare-presidenciale. Ndër të tjerash, ekspertët kanë pohuar se institucionet vendore kanë anashkaluar zbatimin e Kushtetutës së Kosovës.

Baraliu: Të gjitha nenet në Kushtetutë duhet të ripunohen

Mazllum Baraliu, njohës i Kushtetutës së Kosovës ka thënë për revistën "Paqja" se mangësia e aktit më të lartë juridik është mospërcaktimi i historisë së kaluar të popullit tonë.

"Kjo Kushtetutë është e mangët që nga preambula e saj, sepse nuk përmendet e kaluara e popullit tonë. Kushtetuta ka penguar shumë procese, për arsye se nuk ka qenë një akt siç është proklamuar nga bashkësia ndërkombëtare dhe nga disa qarqe të brendshme", - është shprehur Baraliu.

Ai ka thënë se, në tërësi, duhet të ripunohen të gjitha nenet e Kushtetutës dhe të bëhet një kushtetutë e re.



"Duhet të rishkruhet një kushtetutë e re, në të cilën duhet të eliminohen të gjitha vetitë negative që penguan proceset elektorale dhe institucionale, penguan konstituimin e organeve, proceset ekonomike dhe politike", - ka deklaruar Baraliu.

Smaka: Institucionet vendore kanë anashkaluar zbatimin e Kushtetutës

Edhe eksperti i çështjeve juridike-kushtetuese, Riza Smaka, ka thënë se të gjitha institucionet vendore e kanë anashkaluar zbatimin e Kushtetutës.

"Mangësitë e evidentuara në këtë akt juridik, burojnë edhe nga fakti se ajo është hartuar me nxitim dhe nuk buron nga vullneti i popullit të Kosovës, por nga një dokument politik, siç është plani i presidentit Ahtisari", - është shprehur ai.

Smaka, ndër të tjerash, ka thënë se Kushtetuta e Kosovës ka vakuum juridik si dhe dispozita kontradiktore.

"Pika e parë, Kushtetuta jonë nuk përfillet sa duhet, ndërsa pika e dytë, në Kushtetutë ka edhe boshllëqe e vakuume juridike si dhe dispozita kontradiktore", - ka thënë Smaka.

Shala: Duhet të amendamentohet neni 86 për zgjedhjen e Presidentit

Ndërkaq, profesori i së Drejtës Kushtetuese, Xhavit Shala, ka thënë se institucionet vendore nuk e kanë zbatuar Kushtetutën në tërë meritorin e Kosovës.

"E meta e kësaj Kushtetute ka qenë moszbatimi i saj në të gjithë territorin e Kosovës nga institucionet e Kosovës. Kjo



Kushtetuta e Kosovës u miratua më 9 prill 2008

Më 9 prill të vitit 2008, në një seancë solemne, 107 deputetë, nga 120 sa ka Kuvendi, me aklamacion e kishin miratuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kjo Kushtetutë, që i ka rrënjët te Pakoja e ish-ndërmjetësuesit ndërkombëtar për zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës, Marti Ahtisari, e përcakton Kosovën shtet qytetar. Hartimi i këtij dokumenti ishte bërë nga Komisioni Kushtetues, i cili kishte 18 anëtarë dhe kryesohej nga zëvendëskryeministri aktual i Kosovës, njëherësh ministër i Drejtësisë, Hajredin Kuçi.

Gjatë këtyre tre vjetëve, akti më i lartë juridik dhe politik i vendit është sfiduar nga institucionet kryesore të shtetit të Kosovës, duke u shkelur disa herë. Në shtator të vitit 2010 u konstatua rasti i parë i shkeljes së Kushtetutës nga Fatmir Sejdiu, i cili, krahas postit të presidentit të Kosovës, ushtronte edhe pozitën e kryetarit të LDK-së. Pas "rastit Sejdiu", Kushtetuesja u mor edhe me një rast tjetër, duke konstatuar se edhe në Komunën e Rahovecit ishte shkelur Kushtetuta, kur ish-kryetari i kësaj komune, Qazim Qeska, kishte dhënë dorëheqje e më vonë ishte rikthyer në postin e kryetarit.

GJK-ja e kishte konstatuar shkelje të Kushtetutës edhe pagesën prej tre mijë eurosh për Radio Televizionin e Kosovës (RTK). Së fundi, doli se jo vetëm ish-presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu e ish-kryetari i Komunës së Rahovecit, Qeska, e kishin shkelur Kushtetutën, por se atë e kishte shkelur edhe vetë Kuvendi gjatë procedurës së zgjedhjes së Behgjet Pacollit president.

Përpos institucioneve vendore, për shkelje të Kushtetutës është akuzuar edhe misioni i EULEX-it. Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës e kanë akuzuar këtë mision se e ka shkelur Kushtetutën në rastin e ngritjes së fletarrestimit për deputetin Fatmir Limaj, mirëpo GJKK-ja ende nuk është deklaruar për këtë çështje. Ndërkaq, për këto tre vjet, Kushtetuta nuk është shtrirë asnjëherë në veriun e Kosovës.



Kushtetutë ka pasur të meta edhe disa çështje të tjera: çështjen e përfaqësimit, pra krijimin e sistemit proporcional me një zonë, që ka dëshmuar se nuk është adekuate, pastaj diskriminimin pozitiv për minoritetet, si dhe epërsia e Pakos së Ahtisarit karshi kësaj Kushtetute", - ka theksuar Shala.

Duke i përmendur nenet që janë të nevojshme të ndryshohen, Shala ka thënë se ky akt duhet të bëhet më i implementueshëm.

"Është e domosdoshme të bëhen disa ndryshime në Kushtetutë, sidomos në ato nene, të cilat do ta bënin këtë dokument me të implementueshëm. Kushtetuta e Kosovës ka nevojë të amendamentohet, sidomos neni 86, që ka të bëjë me zgjedhjen e presidentit, si dhe duhet të ndryshohet neni 4, i cili duhet të precizojë se Kosova është shtet demokratik, me një sistem të qeverisjes parlamentare-presidenciale", - ka thënë profesor Shala.

Hyseni: Kushtetuta nuk zbatohet për shkak të problemeve politike

Ndërkaq ish-kryetari i Komisionit Parlamentar për Legjislacion, Bahri Hyseni, ka thënë se Kushtetuta e Kosovës në disa raste nuk zbatohet edhe për shkak të problemeve politike.

"Problemet rreth zbatimit praktik të Kushtetutës së Kosovës ekzistojnë.

Në rrethana të tilla, ku ekzistojnë probleme politike, ka edhe probleme të tjera, por megjithatë si përfundim mund të themi se nga koha kur e kemi Kushtetutën, institucionet kanë bërë një progres në zbatimin e saj", - ka deklaruar Hyseni. ■



Sfidat e kushtetutshmërisë

Ma. sc. Flamur HYSENI

Publikimi i Vendimit (Aktgjykimit) të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 30 mars 2011, automatikisht e ndryshon klimën politike dhe funksionimin e institucioneve më të larta shtetërore të vendit. Përmes këtij Vendimi (Aktgjykimi) hapen një mori sfidash, si kushtetuese, ashtu edhe politike. Si sfida kushtetuese do të jenë formulimi dhe qëndrueshmëria e dobët e dispozitave kushtetuese, sidomos atyre që kanë të bëjë me procedurën e zgjedhjes së Presidentit të Republikës, ndërsa si sfida politike do të jenë gjendja në një situatë politike, e cila domosdoshmërisht do të dërgojë në diskutimin për ndërrimin e formulës së koalicionit qeverisës. Në këtë aspekt, funksionimi i institucioneve vitale shtetërore (legjislativi dhe ekzekutivi) janë në një gjendje bllokuese, gjendje nga e cila do të dilet vetëm me shkuarjen në zgjedhje të parakohshme parlamentare (shih mundësinë kushtetuese, përkatësisht nenin 82 të Kushtetutës (Shpërndarja e Kuvendit), paragrafi 3, i cili përcakton afatin 60 ditor për zgjedhjen e Presidentit dhe krijimi i kësaj situate momentale, bën që të jetë e pashmangshme mundësia e shpërndarjes së Kuvendit dhe shpallja e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, sepse askush nuk mund të garantojë përkrahjen e zgjedhjes së propozimit të Kandidatit për President nga ana e koalicionit aktual, ose mundësia e ndërrimit të formulës së qeverisje, variant vështirë i realizueshëm...!).

Duke iu referuar Vendimit (Aktgjykimit) të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i cili u nxor me shtatë vota për dhe dy vota kundër, kuptohet se Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i datës 22 shkurt 2011, për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, nuk do të jetë në fuqi si i tillë që nga dita e publikimit të tij dhe ai u shpall jo-kushtetues, sepse është në kundërshtim me nenin 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Atëherë hapet diskutimi se Presidenti i Republikës së Kosovës, i zgjedhur nga Kuvendi më datë 22 shkurt 2011 dhe qëndrimi i tij në funksion të detyrës prej 22 shkurt – 30 mars 2011, ishte vetëm president faktik (formal), apo edhe kushtetues – juridik (Presidenti përfaqësoi shtetin brenda kësaj periudhe kohore në dy shtet fqinje, në njërin prej tyre u nderua me titull nga një Universitet). Në këtë drejtim duhet të shtrohet edhe një çështje tjetër, se a mund ta gëzojë ky president statusin e "ish Presidentit", për periudhën kohore prej datës 22 shkurt – 30 mars 2011? Kjo mendoj se do të hyjë si një rast i veçantë në praktikën kushtetuese

të Republikës së Kosovës (shih dhe analizo me vëmendje versionin shqip të Vendimit (Aktgjykimit) të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës të datës 30 mars 2011, sidomos pikën II, të pjesës qenësore (vendimmarrëse) të Vendimit (Aktgjykimit), faqe 13, i cili thotë: SHPALL, me shtatë vota për dhe dy kundër, se Vendimi i Kuvendit të Republikës se Kosovës, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, më 22 shkurt 2011, është jo - kushtetues dhe nuk do të jetë në fuqi nga data e publikimit të tij në përputhshmëri me nenin 116.3 të Kushtetutës - meqenëse është në kundërshtim me kërkesat e nenit 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe parimet demokratike të mishëruara aty).

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kanë efekte juridike detyruese dhe hyjnë në fuqi menjëherë ditën e publikimit të tyre. Në rastin konkret, Vendimi (Aktgjykimi) i Gjykatës Kushtetuese i datës 30 mars 2011 është obligues për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe automatikisht Kryetari i Kuvendit ushtron detyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës në afat prej 60 ditësh dhe brenda kësaj periudhe kohore (prej 60 ditësh) duhet të procedohet për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës. Nëse brenda kësaj kohe Kuvendi nuk mund ta zgjedhë Presidentin e Republikës, atëherë shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e parakohshme parlamentare, të cilat duhet të mbahen brenda 45 ditëve (shih nenet 82 dhe 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila hyri në fuqi më 15 qershor 2008).



Shikuar në aspektin e situatës së krijuar momentalisht, kur vendi po gjendet në një situatë politike momentale shumë të komplikuar, me një opozitë, e cila po e shfrytëzon maksimalisht *"dobësinë e legjislacionit dhe Kushtetutës"* (legjislacionit i cili ka kundërthënie të madhe të normave ligjore dhe paqartësi të tyre), për ta bllokuar procesin edhe ashtu të komplikuar të konstituimit të organeve të reja shtetërore, po del që po futemi domosdoshmërisht në një krizë të thellë politike, gjithsesi edhe kushtetuese, sepse pa ndryshimin e kushtetutës dhe ligjit për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, përsëri do ta kemi gjendjen e njëjtë, edhe pse eventualisht do të shkohet në zgjedhje të reja parlamentare (shih lidhur me këtë ligjin për të drejtat dhe privilegjet e deputetëve të Republikës së Kosovës, ligj i cili nuk i obligon në asnjë mënyrë deputetët, kur është fjala për rastet e tilla, si për shembull rasti i zgjedhjes së Presidentit dhe në situata të tilla opozita di të jetë unike dhe e bllokon procesin zgjedhor në Kuvend, po ashtu lidhur me këtë qëndron edhe një bazë më e fuqishme për veprim nga ana e deputetëve të opozitës, shih nenin 70, paragrafi 1 (Mandati i Deputetit) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës).

Në aspektin e funksionimit të një demokracie më stabile dhe institucioneve (Kuvendit, sidomos pjesës së opozitës) politikisht më përgjegjëse, do të duhej të veprohej duke arritur një marrëveshje politike konsesuale, për t'i ikur thellimit të krizës institucionale dhe politike në vend, marrëveshje e cila do t'i paraprinte hapjes së një procesi për ndryshimin e Kushtetutës dhe ligjit për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare. Në situatën çfarë po na imponojnë të hyjmë rrethanat e krijuara, partitë politike po tregojnë se janë plotësisht të papërgjegjshme politikisht dhe nuk po i kryejnë obligimet e tyre politike për interesin e përgjithshëm të vendit (bëjeni dallimin e rolit të opozitës në Republikën e Shqipërisë me atë në Republikën e Kosovës për ta rrëzuar koalicionin qeverisës nga pushteti, atje përdoren mjetet politike, këtu përdoren mjetet kushtetuese – ligjore).

Është e vërtetë që Kushtetuta dhe legjislacioni momental në fuqi në Republikën e Kosovës nuk i obligon deputetët opozitarë të jenë aktivë dhe ta përkrahin konstituimin e organeve vitale shtetërore, por këtë e imponojnë rregullat e demokracisë dhe të interesit të përgjithshëm, ndërsa deputetët opozitarë duhet ta kenë të qartë se rregullat e demokracisë, nëse ata dëshirojnë t'i gjejnë për t'i parë, po ju tregojë se nuk do t'i gjejnë fare, sepse si të tilla për t'i lexuar si rregullat kushtetuese – ligjore nuk do t'i gjeni kurrë, sepse nuk ekzistojnë (janë abstrakte), por këto krijohen prej momenti në moment dhe i paraprijnë ndërtimit të rregullave ligjore dhe forcimit të frymës demokratike në një shoqëri që pretendon të jetë dhe të ketë institucione demokratike (shih shkrimin autorial të autorit të këtij shkrimi, me titull: "Për qeverisje më të mirë, opozitë më e fuqishme", të botuar në Revistën "Paqja", nr. 49, 19 dhjetor 2010).

Prandaj, Vendimi (Aktgjykimi) i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 30 mars 2011, përpos që do të ketë pasoja juridike, në një aspekt do të ketë edhe pasoja politike, sepse situata momentale me një Kushtetutë të tillë, e sidomos me një nen 86 të saj në fuqi, vështirë se do t'ia dalë ta tejkalojë këtë gjendje kushtetuese – politike në vend, pa u shpallur zgjedhjet e reja të parakohshme parlamentare, aq më tepër kur kihet parasysh fakti se edhe presidentja e re konsensuale sipas paralajmërimeve mund të kontestohet nga Gjykata Kushtetuese (nëse realizohen përpjekjet e kryeparlamentarit Krasniqi dhe Lëvizjes Vetëvendosje). Mundësia e vetme momentale për ta vazhduar jetëgjatësinë e këtyre institucioneve është arritja e një marrëveshje politike të propozimit të kandidatit konsesual për President të Republikës së Kosovës, i cili do të ishte i pranueshëm edhe për partitë opozitare, ose varianti i cili do të ishte më shpresëdhënësi për ta vazhduar procedimin me krijimin e institucioneve në mënyrë të plotë do të ishte përsëritja e ndërtimit të koalicionit qeverisës të periudhës 2001 – 2004 (analizo rrethanat e krijuara momentale në Kosovë, po ashtu ndërtimin e traditës politike dhe demokratike, se a ka nevojë zhvillimi i demokracisë kosovare, së paku edhe pesë vite, të ketë opozitë të fuqishme parlamentare, e cila në momente të caktuara domosdo do të luante rolin e një opozite dekonstruktive...?). ■

REGJISTRIMI PAS 30 VITESH

Gëzim QERIMI

Regjistrimi i popullsisë, që në kushte normale duhet të zhvillohet në çdo 10 vjet, në Kosovë nuk është zhvilluar që 30 vjet.

Edhe rezultatet e regjistrimit të zhvilluar 30 vjet më parë janë ende temë e diskutimeve, pasi ishte proces politik i organizuar dhe i manipuluar nga regjimi i Beogradit.

Rëndësia e regjistrimit të popullsisë është e madhe për planifikimet e shtetit dhe hartimin e strategjive. Planet afatmesme nuk mund të imagjinohen pa këto të dhëna.

Duke u nisur nga rëndësia e regjistrimit të popullsisë për të ardhmen e vendit tonë, si qytetarë të përgjegjshëm, duhet të përmbushim detyrën tonë së paku me pjesëmarrje.

E kemi obligim që zyrtarëve të regjistrimit t'u japim të dhënat e vërteta.

Deklarimi i lirë është e drejtë elementare e çdo individi.

Për komunitetet pakicë, regjistrimi i popullsisë ka rëndësi të veçantë në funksion të mbrojtjes së të drejtave të tyre.

Pse është i rëndësishëm regjistrimi i popullsisë?

'Informata është fuqi'

Informata është një ndër parimet themelore mbi të cilën ndërtojmë dhe zhvillojmë mënyrën se si jetojmë. Andaj si të tilla, informatat e ndryshme na nevojiten gjithnjë për të ndërmarrë ndonjë aktivitet, qoftë në jetën e përditshme ose në punë. Me regjistrimin e tërësishëm të popullatës do të mundësohen shumë aktivitete që nuk kanë mundur të iniciohen për shkak të mungesës së të dhënave rreth popullatës dhe amvisërive në Kosovë – aktivitete, të cilat ndikojnë në përshpejtimin e zhvillimit të vendit tonë.

Të dhënat nga regjistrimi i popullsisë dhe ekonomive familjare përmbajnë informata të detajuara, nga të cilat do të përfitojmë të gjithë, sepse me posedimin e tyre jo vetëm institucionet dhe bizneset, por edhe individët do të jenë në gjendje të zhvillojnë analiza dhe hulumtime të bazuara në fakte, të cilat do të ndihmojnë në zhvillimin e mirëfilltë në nivel shtetëror dhe individual.

Po ashtu, duke qenë një nga shtetet e shumta të Evropës, të cilat po ashtu në këtë vit janë duke zhvilluar regjistrimin në vendet e tyre përkatëse, edhe Kosova ka mundësinë që të jetë në hartën e regjistrimeve evropiane. Përderisa regjistrimi do të bëhet me standarde evropiane, ky regjistrim është proces nëpër të cilin duhet kaluar për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian, si dhe në organizatat e tjera ndërkombëtare. Regjistrimi i pranuar ndërkombëtarisht përfaqëson kriter të rëndësishëm të pranimit në BE.

Efekti pozitiv që do japin të dhënat e nxjerra nga regjistrimi dhe të qenët e tyre në dispozicion të plotë për këdo që shpreh interes, i jep edhe më shumë vlerë procesit të regjistrimit, i cili është njëri ndër hapat më madhorë të ndërmarra në Kosovë deri më tani.

Andaj, pjesëmarrja në këtë proces është një obligim që e kemi ndaj vetes, familjeve, fëmijëve, shoqërisë dhe vendit tonë.

Procesi i regjistrimit drejt fundit

Derisa regjistrimi ndodhej në proces e sipër, u shtuan dilemat lidhur me parregullsitë e mundshme. Dyshimet e ngritura kishin të bënin me sigurinë e të dhënave që grumbulloheshin nga terreni dhe me faktin nëse shënimet që vinin a mbroheshin sa duhet në Entin e Statistikave të Kosovës (ESK). Një nga enigmat ishte edhe se kush i menaxhonte serverët e dedikuar të të dhënave të përgjithshme nga të gjitha rajonet e Kosovës në bazën e shënimeve dhe a mos po menaxhoheshin ato nga ndërkombëtarët. Pastaj, dilema të tjera ishin edhe se sa ishin respektuar standardet e sigurisë për bazën e shënimeve që ka vendosur Ministria e Administratës Publike (MAP), për të gjitha institucionet e Kosovës dhe nëse infrastruktura e serverëve ishte brenda rrjetit shtetëror të Teknologjisë Informative të Kosovës apo jo.

Dilemat lidhur me këto çështje i ka hequr kryeshefi i Entit të Statistikave të Kosovës, Ibrahim Shabani, i cili ka thënë se çdo gjë është duke u menaxhuar nga Enti i Statistikave të Kosovës.

"Serverët menaxhohen nga Enti i Statistikës së Kosovës, edhe pse për momentin jemi në procesin e instalimit të tyre, por ata do t'i plotësojnë standardet më të larta të sigurisë", - ka thënë Shabani.

Ndërkaq, sa i përket rrjedhës së procesit të regjistrimit, në 11 ditët e para, sipas Entit të Statistikave të Kosovës, çdo gjë është duke shkuar ashtu siç është parashikuar që nga fillimi. Enti i Statistikave të Kosovës ka bërë të ditur se, për dhjetë ditë, janë regjistruar përafërsisht 1.5 milion banorë.

Edhe në Komisionin Qendror të Regjistrimit vlerësojnë se procesi i regjistrimit është duke u zhvilluar sipas planit të paraparë.

Sabri Zabërxha, menaxher i procesit te regjistrimit, thotë se procesi i regjistrimit do të përmbyllet në afatin e paraparë në 34 komunat e Kosovës.

"Nuk mund të parashikojmë se cili do të jetë numri i banorëve që do të ketë Kosova pas përfundimit të regjistrimit. Mirëpo parashihet që në afatin e paraparë, deri më 15 prill, të regjistrohen të gjithë qytetarët rezidentë dhe jorezidentë, për të cilët mund të marrim të dhëna nga familjarët dhe të afërmit e tyre", - tha ai.



Procesi i regjistrimit mund të vazhdojë, pasi kanë mbetur edhe tri komuna në veri të Kosovës dhe pritet që edhe atje të fillojë regjistrimi i popullsisë dhe i ekonomive familjare. Mirëpo, 31 marsi do të jetë pika referuese edhe për ato komuna", - tha Zabërxha. ■

Viti 2010 me 210 aborte

Përparim BUBLAKU

Dukuria e abortit artificial në Kosovë vazhdon të jetë një problem shqetësues për shoqërinë kosovare. Edhe pse sipas të dhënave nga Qendra Gjinekologjike e Kosovës ky numër ka shënuar rënie, askush në Kosovë nuk e di se sa është numri i saktë i abortit artificial.

"Numri i aborteve i kryer në klinikën tonë, për vitin 2010, ka qenë 210 sosh. Ky numër shënon rënie krahasuar me vitet paraprake. Arsyeja është se këto ndërhyrje sot kryhen pa probleme në të gjitha ordinancat dhe spitalet private që kryejnë shërbime gjinekologjiko-obstetrike", - ka thënë Shefqet Lulaj, drejtor i Qendrës Gjinekologjiko–Obstetrike në Prishtinë. Por, sipas tij, askush në Kosovë nuk e di se sa është numri i saktë i aborteve. Një fakt që ndikon që të mos dihet numri i abortit artificial, ose i njohur ndryshe si ndërprerje e shtatzënisë para kohe, janë edhe procedurat e lehta për kryerjen e abortit. 'Aborti artificial është i lejuar të kryhet pa problem në çdo institucion mjekësor të licencuar, deri në javën e dhjetë të barrës, vetëm me kërkesën e pacientes pa procedura të tjera. Por mangësia është që këto aborte nuk lajmërohen dhe prandaj nuk dihet numri i tyre", - është shprehur Lulaj. Sipas tij, femrat që marrin një vendim të tillë janë të grupmoshave të ndryshme dhe për arsye të ndryshme. "Më tepër këtë metodë e kërkojnë gratë me shumë fëmijë, si dhe ato me kushte të dobëta socio-ekonomike, ato që pa dijen se kanë qenë shtatzëna kanë përdorur barëra, kanë bërë incizime radiografike, ato me probleme bashkëshortore, ato të pamartuarat", - ka thënë Lulaj, duke theksuar se "aborti artificial është një e keqe e madhe, jo humane, dhe me plot rreziqe për pacienten, shëndetin e saj, pasi që janë të mundshme komplikime nganjëherë edhe me pasoja të rënda". Abortin e ka konsideruar si dukuri të rrezikshme për një shoqëri edhe sociologu Murat Gashi, i cili ka thënë se një gjë e tillë është e sanksionuar edhe me kodin shoqëror juridik dhe religjioz. "Aborti bënë pjesë në dukuritë psiko-socio-patologjike, i cili shpeshherë mund të ketë edhe pasoja të dëmshme për vetë faktin se është i sanksionuar me kodin shoqëror, juridik dhe religjioz, që nga moment i embrionizimit të frytit, i cili konsiderohet edhe si krim" - ka thënë sociologu Gashi, duke e cilësuar abortin si "shumë të rrezikshëm dhe të dëmshëm për ato që vendosin për një gjë të tillë". Gashi, ka shtuar se aborti artificial lejohet vetëm në raste të caktuara dhe me rekomandimin e mjekut. "Aborti është i lejuar në rrethana të ndryshme, përderisa fryti ende nuk është ndier i gjallë, ose kur kemi komplikime, të cilat e rrezikojnë jetën e shtatzënës. Në të kundërtën, aborti bënë pjesë në dukuritë psiko-socio-patologjike", - ka thënë sociologu Gashi

Bajgora: Aborti i qëllimshëm është krim kundër njerëzimit

Sabri Bajgora, kryeimam në Këshillin e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, ka thënë se feja islame e ndalon rreptësisht abortin artificial, nëse nuk ka ndonjë arsye të fortë, të cilat ju nënshtrohen dispozitave fetare islame. "Islami, e konsideron abortin e qëllimshëm si një krim të rëndë kundër njerëzimit, sepse bëhemi shkaktarë që një foshnjë e vogël, të mos vijë në jetë, e t'i gëzohet asaj", - ka thënë kryeimami Bajgora. Bajgora ka treguar edhe dy arsyet se kur lejohet aborti sipas kritereve që i kanë përcaktuar dijetarët islamë. "Nëse embrioni (fetusi) i foshnjës nuk i ka kaluar 40 ditë, dhe nga mjekët specialistë – muslimanë dhe të devotshëm, konstatohet se fryti mund t'i shkaktojë nënës, dhimbje dhe trauma të ndryshme psiko-fizike, atëherë lejohet abortimi dhe nëse konstatohet se fryti që do të lindë ka të meta patologjike, të cilat janë të pashërueshme, atëherë, sërish, pas konstatimit të mjekëve muslimanë, mund të arrihet deri tek aborti", - ka sqaruar Bajgora. Sipas tij, i vetmi rast që Islami e lejon kryerjen e abortit artificial edhe pas 120 ditëve të frytit ose frymëzimit të shpirtit në të, është kur jeta e nënës rrezikohet për vdekje. "Me pëlqimin e mjekëve specialistë muslimanë, lejohet abortimi i këtij fryti, sepse në këtë rast, nuk rrezikohet jeta e nënës, e cila është më e vlefshme sesa jeta e foshnjës. Nëna konsiderohet si shtyllë e familjes dhe për këtë shkak nuk është e logjikshme që jeta e saj të sakrifikohet për fetusin", - ka thënë Bajgora. ■



TË SËMURËT MENTALË, PA PËRKUJDESJE DHE NË RRUGË

Brendon BERISHA

Njerëzit me çrregullime mentale, që i takojnë një kategorie të ndjeshme të shoqërisë sonë, nga institucionet dhe shoqëria kosovare po lihen pa përkujdesjen e nevojshme që u duhet atyre. Përveç kësaj, këta të sëmurë, po lihen të lirë nëpër rrugët e kryeqytetit, e si të tillë shpesh shfaqin rrezik për qytetarët.

Muhamet Gjocaj, zyrtar i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, në lidhje me këtë problematikë ka thënë se që të mos mbesin rrugëve dhe të kenë trajtim më të mirë dhe njëkohësisht të mos i pengojnë qytetarët, për këta njerëz do të duhej të kujdesej komuna, për shkak se komuna duhet të kujdeset për banorët e vet.

"Strehimi, kujdesi, ndërtesa sociale, të gjitha këto bëhen nga organet komunale. Edhe ashtu, komuna i ka marrë përgjegjësitë me rritjet e reja për vet administrim. Ne, qysh prej janarit të vitit 2009, ua kemi bartur përgjegjësitë komunave për krejt shërbimet sociale. Ndërsa tani vetëm i monitorojmë kualitetet e shërbimeve që i ofrojnë ata. Për çdo banor të Prishtinës duhet të kujdeset komuna. Ajo e ka Qendrën për Mirëqenie Sociale dhe ata duhet të merren me ta", - ka deklaruar Gjocaj.

Ndërkaq, zëdhënësi i komunës së Prishtinës, Muhamet Gashi, mendon ndryshe nga Gjocaj, duke thënë se faji, se përse këta njerëz janë në rrugë dhe pa përkujdesje, do të duhej kërkuar te Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe te Ministria e Shëndetësisë.

"Them kështu sepse për ata të sëmurë duhen objekte të veçanta, ngase nuk mjafton që atyre t'u ndërtohet një objekt dhe të lihen aty, por ata duhet të mbikëqyren dhe të jenë nën trajtimin e mjekëve, pra, për ta duhet trajtim i veçantë", - ka deklaruar zëdhënësi Gashi.

Gjocaj, zyrtar i MPMS-së, mendon se një pjesë të fajit, se përse këta njerëz


Muhamet Gjocaj


Faik Hoti

janë në rrugë, e që disa prej tyre shfaqin edhe rrezik për qytetarët, i duhet hedhur Ministrisë së Shëndetësisë, ngase sipas tij, MSH-ja, së pari, duhet t'i klasifikojë këto kategori të të sëmurëve mendorë e pastaj atyre duhet t'u bëhet strehimi adekuat.

"Disa nga ata janë të rrezikshëm dhe të tillët zakonisht janë raste psikiatrike dhe, me siguri, ish dashur që me ta të merrej Ministria e Shëndetësisë. Mjekësia i ndan në kategori ata me raste psikiatrike, të cilët trajtohen dhe rastet e tjera që janë me ngecje në zhvillim", - ka thënë ai.

Gjocaj, gjithashtu tha se MPMS-ja bën përpjekje gjithmonë që t'i socializojë ata që nuk kanë përkujdesje familjare, ndërsa ata që kanë përkujdesje familjare, MPMS-ja mundohet t'i ndihmojë familjet e tyre në mënyra të ndryshme, me qëllim që të tillët të mbesin në familjet e tyre.

Ndërsa, zëdhënësi i Ministrisë së Shëndetësisë, Faik Hoti, ka deklaruar se çështja e personave me çrregullime të natyrës mendore është një problematikë që kërkon një trajtim të bashkërenditur ndërmjet institucioneve të nivelit qendror dhe atij lokal.

"Sa i përket akomodimit të tyre janë institucionet speciale përkatëse dhe institucionet e tjera. Është pjesë e përgjegjësive të përbashkëta, ku hise kanë edhe komunat, edhe MPMS-ja, edhe MSH-ja dhe krejt shoqëria kosovare", - ka thënë Hoti.

Ndërsa, sa i përket efektit që ka në shoqëri qëndrimi i këtyre të sëmurëve në rrugë, profesori i lëndës së sociologjisë në juridik, Beqir Sadikaj, mendon se kur njerëzit i shohin ata të sëmurë, sidomos të rinjtë, kjo u lë një përshtypje dhe ndjenjë të keqe. Ata kanë efekt te fëmijët, kanë efekt te të rriturit, janë edhe të rrezikshëm ngase në momente të caktuara mund të bëhen agresivë, si shembull mund të marrim rastin e fundit që ndodhi në Shqipëri, ku një i sëmur mendor vrau babanë e tij. Dhe këta të sëmurë, përveç të tjerash, krijojnë përshtypjen se nuk ka një interesim institucional për ta.

"Mendoj se Qeveria e Kosovës dhe shteti i Kosovës do të duhet të hartojë një projekt me prioritet, ku do të bëhet koncentrimi i këtyre njerëzve me një përkujdesje shtetërore. Pra, një qendër strehimi për ta, ku do të kishte përkujdesje për shëndetin e tyre, si dhe të tillët të largoheshin nga rruga. Pra, ky është një problem që duhet trajtuar nga shteti me prioritet, ngase familjet janë të pafuqishme në trajtimin e këtyre rasteve, nëse nuk ndihmohen nga shteti", - ka theksuar profesori, Sadikaj.

Ndërsa për shkaqet që kanë bërë që këta njerëz të sëmuren mendërisht, Sadikaj mendon se ato mund të numërohen duke filluar nga rrethanat shoqërore, kriza ekonomike, traumat e luftës, intensiteti dhe dinamika e shpejtuar e zhvillimit të Kosovës pas lufte, tjetërsimi i njerëzve, e me tjetërsim ai kupton se në njëfarë mënyre njerëzit janë dehumanizuar dhe janë individualizuar.

Derisa disa nga institucionet kosovare ia hedhin fajin njëra-tjetrës se kush do të duhej të merrej me këta të sëmurë me çrregullime mentale, ata mbesin në rrugë dhe nën mëshirën e fatit, e njëkohësisht disa prej tyre shfaqin rrezik permanent për qytetarët.



Pusetat - rrezik për jetën e qy

Astrit VELIQI

Pusetat e hapura në lagjet e Prishtinës janë bërë një brengë e madhe për qytetarët kudo, ngase shumë prej tyre edhe kanë pësuar lëndime, duke rënë në to.

Njëri nga viktimat që ka pësuar nga këto puseta, të cilave u janë vjedhur kapakët, është fëmija 13 vjeçar Besart Maliqi, i cili me të rënë në pusetë ka marrë lëndime të rënda trupore.

Fëmijët lëndohen në puseta

Ai ka qenë duke shkuar në shkollë kur, nga pakujdesia e tij, ka rënë në një pusetë, e cila ka qenë e hapur , duke pësuar kështu lëndime në kokën e tij.

'Ka qenë ditë më shi dhe, duke shkuar në shkollë, nuk e kam parë që puseta ishte e hapur, pa kapak, dhe më ka rrëshqitur këmba e kam rënë brenda, ku kam vrarë dorën e majtë dhe kokën", - rrëfen Besarti.

Ai thotë se ka qenë me fat dhe nuk ka rënë krejt poshtë, ngase pasojat e lëndimit do të kishin qenë edhe më të mëdha. Ai fajëson institucionet e mirëmbajtjes që merren më këto punë, të cilat nuk i kanë vënë kapakë pusetave, dukë bërë që fëmijët të pësojnë lëndime.

Besarti u bën apel sidomos moshatarëve të tij që të kenë kujdes gjatë lëvizjes së tyre, ngase edhe ata një ditë mund të jenë viktimë e papërgjegjësisë institucionale në Kosovë.

Por kush, në të vërtetë, mbetet fajtor për mirëmbajtjen e pusetave në Prishtinë, institucionet komunale apo vetë qytetarët? Kësaj pyetjeje më së miri i përgjigjet edhe vetë Komuna e Prishtinës e cila thotë se vjedhja e kapakëve të pusetave në rrugët e kryeqytetit është bërë dukuri shqetësuese për udhëheqjen komunale dhe për qytetarët në përgjithësi, të cilët po rrezikohen çdo ditë.

"Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjenca Civile ka kontaktuar disa herë udhëheqjen rajonale të Policisë së Kosovës, takime në të cilat është biseduar për ndalimin dhe parandalimin e kësaj dukurie", - thuhet në komunikatën e lëshuar nga komuna e Prishtinës.

KP: Vjedhësit do të dënohen

Sipas tyre, Komuna e Prishtinës ka adresuar disa herë shkresa te të gjitha bizneset private në rajonin e Prishtinës, që



...ytetarëve

merren me grumbullimin e metaleve që të mos i blejnë kapakët e të gjitha llojeve të pusetave, ngase pusetat dhe kapakët e kontejnerëve të mbeturinave vidhen nga hajdutët dhe keqbërësit, të cilët në rastet më të shpeshta i shesin kapakët e tyre në vend të hekurit.

Bëhet e ditur, po ashtu, se në këtë drejtim është mobilizuar edhe inspeksioni komunal i komunës, i cili do të kontrollojë çdo ditë depot ku mblidhen hekurishtet. Nëse haset në kapakët e pusetave, në puseta dhe në kapakë të kontejnerëve të mbeturinave, do të merren masa të ashpra ligjore, madje inspeksioni ka kërcënuar edhe me mbylljen e bizneseve.

Por kush në të vërtetë merret më këta kapakë të puseteva? Pse hiqen kapakët e tyre dhe cila është vlera e tyre materiale? Si duket përgjigjja është shumë e thjeshtë.

Këta kapakë hiqen nga persona që merren më shitjen dhe blerjen e hekurishteve kudo në Kosovë.

Edhe pse ky veprim i tyre në plan të parë është antiligjor, megjithatë varfëria e skajshme në Kosovë ka bërë që kjo punë, për shumë qytetarë, të mbetet e vetmja rrugë për të mbijetuar.

Punë për mbijetesë

Njëri prej mbledhësve të këtyre pusetave është edhe M. Haziraj, i komunitetit rom, i cili si i vogël ka nisur të shes hekurishte, për ta mbajtur familjen e tij.

Ai thotë se duke mos gjetur zgjidhje tjetër, që në mëngjes e deri në mbrëmje nëpër rrugët e kontejnerët mbledhë pjesë të hekurishteve e kënaçeve, dhe në fund i shet, për ta mbajtur familjen.

Edhe pse nuk e pranon se personalisht i merr kapakët e pusetave, por objekte të tjera, Haziraj, deklaron se do të ishte i lumtur po të kishte në një të ardhme një punë më stabile dhe më të mirë.

Po ashtu, vjedhja e kapakëve të pusetave në kryeqytet i kushton shumë komunës.

Kjo dukuri, fatkeqësisht, është bërë e zakonshme, pasi rrallëkush është dënuar, e mbledhësit e hekurit të vjetër më së lehti e kanë t'i marrin pusetat dhe t'i sheshin si mbeturinë në depot grumbulluese të hekurishteve në kryeqytet.

Prandaj si të tillë, kapakët e vjedhur përfundojnë si mbeturina metalike.

Për pak para që fitojnë, ata që i 'vjedhin' i shkaktojnë dëm të konsiderueshëm kompanisë së Ujësjellësit 'Prishtina', përkatësisht sektorit të ujërave të ndotura që është përgjegjës edhe për kapakët.

Vjedhjet në rritje

Ata thonë se çdo vit detyrohen të shpallin tender pikërisht për kapakët.

Prej një kapaku që ujësjellësit i kushton nga 40 deri në 180 euro, ata që e kryejnë këtë 'hajni' duke e shitur me 16 centë kilogramin, fitojnë nga 2 deri mbi 20 euro, varësisht nga pesha e kapakut që sillet prej 13 e deri në 148 kilogramë.

Shefqet Sopi, menaxher ekzekutiv në rrjetin e ujërave të ndotura në KUR 'Prishtina', ka thënë se rastet e vjedhjes janë të shumta.

Në lidhje më këtë fenomen, Komuna e Prishtinës u bën thirrje të gjithë qytetarëve që nëse hasin persona duke vjedhur kapakë të pusetave në rrugët e kryeqytetit të lajmërojnë inspeksionin e komunës në numrat e tel: 038 245 666 dhe 038 245 777 dhe policinë e rajonit.

Po ashtu bëhet e ditur se edhe në Drejtorinë e Shërbimeve Publike është duke u biseduar që të gjendet një mundësi për sigurimin e të gjitha llojeve të pusetave që të vështirësohet vjedhja e tyre, por se a do të ndodh kjo mbetet të shihet në një të ardhme të afërt. ■



Mimoza Kusari - Lila Muhamet Sadiku

DOMOSDOSHMËRIA PËR REZERVA SHTETËRORE

Lulzim AHMETI

Krijimi i rezervave shtetërore nga ana e Institucioneve të Kosovës shihet si domosdoshmëri për shtetin, për shkak të kapaciteteve të vogla për prodhimin vetjak. Krejt kjo ka ardhur tani edhe si shkak i bllokadave të ndryshme që shtetet e rajonit po i bëjnë Kosovës kohë pas kohe. Në muajt e fundit, tregtarët kosovarë druajnë edhe për grurin, pasi që Serbia e ka ndaluar importimin e kësaj kulture drejt Kosovës. Zyrtarë të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për të parandaluar çrregullimet në tregun kosovar, kanë thënë se do të fillojnë grumbullimin e rezervave shtetërore të mallrave. Sipas tyre, do të bëhet krijimi i rezervave për produktet strategjike, gjë që ka dalë si nevojë për shkak të pamundësisë së kapaciteteve të Kosovës për t'i plotësuar nevojat e veta për bukë. Aktualisht, Kosova, sipas statistikave, plotëson vetëm pak mbi 50 për qind të nevojave të saj për bukë me prodhim vetjak. Njohës të çështjeve ekonomike thonë se për krijimin e rezervave shtetërore duhet të përdoret modeli zviceran.

Muhamet Sadiku, ligjërues në Universitetin e Prishtinës, ka thënë se Kosova së pari duhet të krijojë legjislacionin për themelimin e rezervave shtetërore. Sipas tij, rezervat shtetërore janë tepër të rëndësishme dhe të domosdoshme për të mbajtur një nivelim të çmimeve të produkteve ushqimore. "Kosova duhet të formojë legjislacionin për vendosjen e rezervave shtetërore për disa artikuj ushqimor, për të shmangur mungesën e tyre dhe veprimet spekulative të tregtarëve. Ngritja e çmimeve e disa artikujve ushqimorë është atak ndaj standardit të ulët të popullatës", - ka thanë Sadiku. Me krijimin e rezervave shtetërore, përveç që vendi sigurohet në raste krizash, sipas profesor Sadikut, ruhet edhe stabiliteti i tregut. "Rezervat janë të nevojshme si për popullatën, ashtu edhe për FSK-në. Tregu i Kosovës është i ndjeshëm nga veprimet spekulative të vendit, ose nga importi. Duhen gjetur mënyrat për ta stabilizuar tregun. Jo mbyllja, por rregullimi i tij", - ka pohuar Sadiku.

Rezervat rregullojnë tregun

Për të parandaluar çrregullimet në tregun kosovar, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) do të fillojë grumbullimin e rezervave shtetërore të mallrave. Krijimi i rezervave për produktet strategjike ka dalë si nevojë e pamundësisë së Kosovës për të përmbushur kërkesat për bukë nga prodhimi i vet, si dhe bllokada që po i bëhet nga shtete të ndryshme. Në bazë të Ligjit për Rezervat Shtetërore të Mallrave, MTI-ja është e obliguar që të grumbullojë rezerva të mallrave për të ndihmuar ekonominë vendore, në rast të çrregullimit të tregut. Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se ministria të cilën e drejton ajo, konform ligjit për rezerva është e obliguar që të grumbullojë rezerva të mallrave. Sipas saj, deri më tani kjo nuk ka qenë e mundur, pasi që vetëm në gjysmën e vitit të kaluar ky ligj është miratuar në Kuvendin e Kosovës. "Tani ligji është në fuqi dhe konform këtij ligji ne do të fillojmë grumbullimin e rezervave shtetërore të mallrave", - ka thënë ministrja Kusari-Lila. Ajo pret se këto rezerva do të kenë efekt pozitiv në rregullimin e tregut në vend. "Efektet e rezervave ne presim t'i kemi pas një kohe të shkurtër dhe nuk besoj se do të ballafaqohemi me mungesa të mallrave", - ka theksuar Mimoza Kusari-Lila.

Krijim i rezervave të grurit është i nevojshëm

Sipas kryetarit të Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu, deri më tani, Qeverisë i është rekomanduar çdoherë se vendi ka nevojë emergjente për krijimin e rezervave për produktet strategjike. Tani, sipas tij, vendi ka më së shumti nevojë që të krijojë rezervat shtetërore, sidomos ato të grurit. "Qëndrueshmëria dhe stabiliteti i tregut vendor varet nga ajo se çfarë janë rezervat shtetërore. Rezervat shtetërore janë gruri, nafta dhe derivatet e saj, medikamentet e ndryshme mjekësore dhe rezervat në aspektin financiar", - thekson Gërxhaliu. Të gjitha këto, sipas tij, duhet të krijohen në mënyrë emergjente, pasi që tani ekziston edhe baza ligjore. Ndër të tjerash, ai thekson se vendi ka nevojë që të zbatojë modelin zviceran për krijimin rezervave."Duhet të futemi në partneritet publiko-privat, gjë kjo që nënkupton stimulimin e fermerëve për prodhim dhe teprica e prodhimit të përdoret si rezervë shtetërore, ndërsa mungesa e tyre të importohet në bazë të kuotave", - ka thënë Gërxhaliu.

Rezervat shtetërore të mallrave krijohen nga buxheti i Republikës së Kosovës, nga mallrat që vijnë si ndihmë humanitare, nga donacionet në mallra dhe ndihmat financiare, nga mallrat e konfiskuara që kalojnë në pronësi të shtetit, nga veprat e kundërvajtjes administrative dhe nga kryerja e veprave penale që janë të destinuara për rezervat shtetërore të mallrave. ■

PAK INTERESIM PËR TURIZMIN

Kosova nuk e ka rërën dhe detin, mirëpo i ka shtigjet e gjata malore dhe të përshtatshme për skiatorë, të cilat do të joshin shumë turistë të huaj. Por, edhe për kundër kësaj, turizmi në vendin tonë po vazhdon të injorohet. Numri i turistëve që e vizitojnë Kosovën mbetet shumë i vogël. Edhe informacionet në internet për vendet turistike të Kosovës janë të mangëta. Kurse, Zekë Çeku, kryetar i asociacionit të turizmit të Kosovës, ka thënë se zhvillimi i turizmit në Kosovë është në fazën e hershme fillestare

Fatos SHALA

Sektori i Turizmit në Kosovë edhe më tej vazhdon të injorohet nga institucionet e vendit, përkundër mundësive që ka për ta zhvilluar atë. Numri i turistëve të huaj që vijnë në Kosovë në mënyrë individuale vazhdon të jetë shumë i vogël. Po ashtu, për këtë sektor ka pak informata edhe në internet. Nëse një vizitor nga jashtë dëshiron të vijë në Kosovë dhe hyn në faqen e turizmit të vendit tonë që gjendet në ueb-in e Ministrisë së Tregtisë, mund të gjejë shumë pak të dhëna për turizmin e Kosovës. E tëra që mund të bëjë ai vizitor është të kënaqet me një shëtitje virtuale përmes fotografive që janë të postuara në këtë ueb. Por aty ka shumë pak informata. Ajo çka Ministria e Tregtisë kishte bërë në vitin 2010 për sektorin e turizmit ishte slogani: "Kosova, zbuloni bukuritë e reja". Ky ishte slogani që Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) përkatësisht departamenti i kësaj ministrie, kishte bërë për turizmin dhe për ata turistë që dëshironin ta vizitonin Kosovën. Ndërkaq, Zekë Çeku, kryetar i asociacionit të turizmit të Kosovës, ka thënë se zhvillimi i turizmit në Kosovë është në fazën e hershme fillestare. Sipas tij, shifrat e turistëve të huaj në vendin tonë janë ende të ulëta, por trendet janë mjaft inkurajuese dhe premtuese, sidomos nga viti i kaluar. "Sa i përket përkrahjes së gjertanishme institucionale në nivel të vendit, ajo ka qenë shumë e zbehtë, e paorganizuar dhe joefektive, për shkak të mungesës së njohurive dhe kapaciteteve profesionale, gjithsesi edhe për shkak të buxhetit tejet të limituar. Diçka më shumë janë angazhuar institucionet e nivelit komunal. Zhvillimi i turizmit në Kosovë duhet të jetë ndër tri prioritetet kryesore zhvillimore dhe duhet të jetë vërtet lokomotivë e zhvillimit të sektorëve të tjerë, falë ndikimeve dhe efekteve multiplikative", - është shprehur Çeku. Ai, më tutje, ka thënë se Kosova ka potenciale, resurse dhe burime të pashtershme për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe industrisë turistike. "Në bazë të vlerësimeve dhe lëvizjeve të turistëve në objektet hoteliere të anëtarësisë së asociacionit kosovar të turizmit, vizitorët më të shpeshtë kanë qenë nga Shqipëria, duke shënuar një rritje të shumëfishtë krahasuar me një vit më parë. Pastaj, sipas radhës mund të përmendim vizitorët nga Turqia, Britania e Madhe, Italia, Shtetet e Bashkuara, Danimarka dhe Japonia. Vlen të përmendet edhe shtimi i vizitave të ndërkombëtarëve që punojnë dhe jetojnë në Kosovë, të cilët konsiderohen si turistë të jashtëm", - është shprehur ai. Në anën tjetër, sipas disa statistikave zyrtare, thuhet se gjatë vitit 2009 në Kosovë kanë qenë 52 mijë vizitorë vendorë dhe 39 mijë vizitorë të jashtëm, shifër e cila është më e ulët se numri i turistëve mujorë në Maqedoni ose Serbi, vende të cilat po ashtu nuk kanë det, e të mos krahasohemi me Shqipërinë dhe Malin e Zi, ose Kroacinë. Gjatë vitit të kaluar në Serbi kanë qëndruar rreth 2 milionë turistë, shumica prej të cilëve kanë vizituar kryeqytetin serb dhe qendrën turistike dimërore Kopaonikun. Ndërsa numri i përgjithshëm i turistëve në Maqedoni, vetëm gjatë muajt gusht 2010, ka arritur rreth 110 mijë, shumë më shumë sesa në Kosovë. Shumica prej tyre kanë vizituar Liqenin e Ohrit, Strugës dhe pikat malore: Mavrovën dhe Kodrën e Diellit.

Për ta përmirësuar imazhin e Kosovës karshi investitorëve të huaj, Qeveria e Kosovës shpenzoi rreth 6 milionë euro nëpërmjet kompanisë izraelite "Satchi&Satchi", mirëpo efekti i këtyre shpenzimeve po kalon pa u vërejtur për shkak të fokusit të gabuar të marketingut.

Vendet turistike të Kosovës

Në anën tjetër, Kosova llogaritet si një ndër vendet më të pasura me turizëm malor. Disa nga vendet më të frekuentuara janë Brezovica, Malet e Sharrit, Gryka e Rugovës, Shpella e Gadimës, Ujëvara e Mirushës, Burimi i Drinit të Bardhë, Mulliri i Nikës, Prevalla, Lumi Luboten dhe monumentet kulturore. Ndërkohë që e gjithë trashëgimia jonë llogaritet të ketë një llojllojshmëri, duke u nisur që nga stili osman e bizantin, e deri tek ato moderne të vendit.



FMN-ja sikurse uji i detit



Osman D. GASHI

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), huadhënësi më i madh botëror, ia ka sjellë punën në zgrip Kosovës në mosmarrëveshjet me qeverinë e Thaçit. Qeveria është ndodhur në një situatë të vështirë ku i është dashur të zgjedhë: ose të thyejë premtimet e veta elektorale për rritjen e pagave në njërën anë, ose të bëhet e dëgjueshme ndaj rekomandimeve të FMN-së për mosrritjen e këtyre pagave.

Kur është fjala te huadhënia, të cilën FMN-ja ua jep shteteve të caktuara, kjo, në një farë forme, i bën të lidhura ose të varura këto shtete ndaj këtij institucioni. Nëse marrin hua ose asistencë teknike financiare, kjo është sikurse uji i detit që nëse e pi, je edhe më i etur pastaj.

FMN-ja si institucion ka edhe rolin mbikëqyrës të zhvillimit ekonomik ndaj vendeve të anëtarësuara. Ajo ka dhënë rekomandime për qeverinë kosovare që rritja të mos jetë aq sa ka premtuar Thaçi, por të jetë më e vogël. Mirëpo, qeveria ka zgjedhur opsionin e parë, që t'i rrisë pagat edhe pse FMN-ja nuk e rekomandon një gjë të tillë. Ky veprim do të çojë te prishja e marrëveshjes për ndihmesë nga FMN-ja dhe, kësisoj, Kosova rrezikon të humbasë vlerën e premtuar prej 200 milionë eurosh.

Kryeministri i Kosovës nuk e sheh këtë rritje si negative për të ardhmen ekonomike të Kosovës, ngase ky ndryshim në nivelin e pagave nuk e rrezikon rezervën buxhetore të shtetit. Ai i është revanshuar FMN-së, duke deklaruar se përqindja e madhe në rritjen e pagave nuk është ngarkesë për buxhetin, sepse pagat bazë nuk janë të larta. Buxheti i Kosovës në parim është miratuar ditën e premte në Kuvend, por me disa ndryshim-propozime. Në këtë konstelacion veprimesh të kosovarëve pritet të shihet se çfarë do të pasojë në marrëdhëniet Kosovë – FMN.

Tek e fundit, nëse këto pasoja tejkalohen vetëm me prishjen e kësaj marrëveshje dhe nuk përcillen me ndonjë penalizim shtesë, kjo mosdëgjueshmëri e vendorëve ndaj rekomandimeve të FMN-së do të kapërdihej disi.

Tërë ata ekspertë e profesionistë, që ka përreth kryeministri, nuk mund t'iu ketë ikur ky "detaj" në raport me FMN-në, ose ata e kanë tejkaluar këtë problematikë, duke e llogaritur si të vogël, në mënyrë që premtimi i kryeministrit të realizohet.

Kundër këtyre veprime të kryeministrit dhe qeverisë së tij më të zëshëm janë opozita, duke e kundërshtuar propozimbuxhetin për vitin 2011, duke votuar kategorikisht kundër në Kuvend. Disa parti opozitare, me kësisoj kundërshtish, luajnë një rol destruktiv, ngase ato nuk ofrojnë ndonjë alternativë tjetër, por vetëm e paraqesin si negativ çdo veprim, ide dhe propozim qeveritar.

Përfundimisht, Kosova, si shtet që është shpallur i pavarur dhe ka 3 vjet shtet, duhet të jetë më këmbëngulëse dhe jo vetëm të shtrijë qafën ndaj çdokujt që i propozon dhe i rekomandon diçka. Edhe në raport me FMN-në, sa i përket mosmarrëveshjeve të fundit, qeveria nuk ka bërë ndonjë mëkat aq të madh që ka qenë e padëgjueshme, ngase duke e jetuar përditshmërinë e vështirë në Kosovë e ka parë si të domosdoshëm këtë ndryshim.

FMN-së i intereson që shtetet të jenë sa më të varura ekonomikisht e financiarisht dhe, si të tilla, në rend global, të jenë të kontrolluara më lehtë. Por, a duhet që kosovarët për çdo veprim që bëjnë të marrin 'amin'-in e ndërkombëtarëve për një gjë të tillë?

Kosova ka një territor të vogël dhe një numër të vogël banorësh, sa një lagje e një metropoli të madh botëror, për shembull Parisi a Stambolli dhe ka një dendësi jo aq të lartë. Me këtë dosje të dhënash, Kosova ka mundësinë që të zhvillohet shumë shpejt, sidomos përmes sektorit bujqësor dhe blegtorisë, duke prodhuar vetë produktet bazë që i nevojiten qytetarëve dhe mos të jetë shumë e varur nga importi. Duke rritur prodhimin vendor, në mënyrë të patjetërsueshme, Kosova do të rriste ekonominë e vet dhe, dalëngadalë, nuk do të varej as nga asistencat e huatë ndërkombëtare, që vërtet janë sikurse uji i detit që kur e pi një i etur, etet edhe më shumë. ■



"Euro-skeptikët e rinj"

Adelina AVDULLAHU

Europianë të rinj" - kështu na pëlqen të na thërrasin. Jemi shtet i ri, padyshim edhe shteti me popullatën më të re në Europë. Ankesat më të shpeshta që mund të dëgjosh nga të rinjtë janë se shteti nuk po punon për interesat e qytetarëve, por ata po punojnë vetëm për interesat e tyre dhe gjoja se ata nuk e kanë prioritet rininë kosovare. Kjo disi bie në kundërshtim me thënien e J. Kennedy: "Mos pyet çfarë bën shteti për ty, por çfarë mund të bësh ti për shtetin". Ndërkohë, neve na pëlqen që të tjerët t'i marrin përsipër obligimet tona, që sa herë nuk mund t'i japim arsye sfidave të jetës të mos i kursejmë komentet nga më të ndryshme se jeta është e padrejtë ndaj nesh. Nuk jemi vetëm ne me skandale e probleme. Në çdo shoqëri problemet janë të pranishme. Mirëpo, gjersa ne qëndrojmë duarkryq, gjithë ditën duke u sorollatur poshtë e lart rrugëve, duke u endur nga një kafene në tjetrën, dhe nuk mërzitemi fare me atë që ndodh përreth, atëherë kush do të përpiqet të na ndihmojë?! Sikur na përshtatet me saktë emërtimi "euroskeptikët e rinj".

Në vendin tonë, kafe-baret i gjen të stërmbushura, bile-bile sheh edhe palë që presin në rend për ta zënë një tavolinë që të ulen e t'i shkëmbejnë hallet dhe dertet e tyre. Po, a e sheh dikë që po lexon ndonjë libër?! Rrallë...Madje rastis t'i thuhet atij që lexon: "mos u shit intelektual". A thua ndodh kështu edhe në Europë? Jo. Atje i sheh me libra në duar në autobus, në rrugë!

Ajo që ta "prish" veshin është edhe gjuha, të cilën e përdorin të rinjtë tanë në rrugë. Është për keqardhje kur në qytet i dëgjon adoleshentët që nuk e kanë fjalorin e pastër e përdorin terma të ndryshëm deri tek ata më banalë. Çështje tjetër është humbja e respektit ndaj të moshuarve. Se një plak qëndron në këmbë në autobus, duke shpresuar se dikush do të solidarizohet me të e t'ia lirojë vendin, të rinjtë tanë nuk e kanë dert. A thua familjarët e tyre i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë të mësojnë dhe të fitojnë një edukatë të lartë, apo që ata t'i humbin vlerat e një rinie të shëndoshë, duke mos e harruar mundin dhe sakrificat, të cilat i bëjnë ata për ne? Por si pasojë e kësaj, nganjëherë të shkon në mendje sikur ndoshta prindërit e tyre nuk mërziten edhe aq shumë për këtë fenomen, ose ndoshta nuk i kanë nën kontroll pasardhësit e tyre.

Sigurisht, mund ta marrim me mend si mund të ndihet një nxënës i shkollës se mesme... Kokën lart, të vishet bukur, të duket "cool" para tjerëve. Përpos obligimeve shkollore, nuk e shqetëson ndonjë problem tjetër, pasi që para se të niset për në shkollë prindi duhet t'ia mbush xhepin me para, pavarësisht nëse ai ka apo nuk ka. Aty nga përfundimi i shkollës së mesme, nxënësi i llastuar fillon të mendojë se ku do të vazhdojë më tutje. Ndoshta është pak vonë për të që të kërkojë ndonjë përgjigje. Edhe ky nuk është ndonjë problem i pazgjidhur, meqë Ministria e Arsimit e rrit numrin e studentëve në universitetin publik. Më kujtohet kur një profesor i im, M. K, na thoshte se "në pamundësi që të gjendet punë dhe perspektivë tjetër për rininë e këtij vendi, ka vite që janë hapur dyert e universitetit publik (po edhe të atyre private), jo vetëm për ata që duan të studiojnë vërtet, por edhe për të gjithë ata që nuk kanë mundësi të gjejnë punë. Paradoksalisht, Universiteti i Prishtinës është shndërruar në zëvendësues të enteve të punësimit".

Se studenti i interesuar pengohet nga ai që shkon në universitet vetëm sa për të humbur kohën nuk diskutohet! Na pëlqen të ankohemi edhe për vështirësitë në nxënien e mësimit, se edhe librat janë të shtrenjta, e shumë çështje të tjera, vetëm e vetëm të mos e hedhim përgjegjësinë mbi vete. Por si mund të themi ashtu kur çdo të tretin e sheh me mobil, kur kafe-baret janë të stërmbushura, kur të gjitha këto kushtojnë?!

Vallë kështu synojmë të integrohemi në Bashkimin Europian? Jam skeptike që në këtë mënyrë mund të arrijmë diku. Shumë të rinj e presin me plot entuziazëm liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës, në mënyrë që të ikin nga ky "realitet i hidhur". Megjithatë, shtrohet pyetja se nga do t'ia mbajnë, të pastrojnë WC e shteteve perëndimore, të bëhen fuqi punëtore e tyre, apo thënë më saktë të bëhen skllevër te tyre?! Dyshoj se ata do t'i hapin dyert për gjithsecilin, fjala bie ta bëjnë drejtor apo ministër, pasi që edhe një thënie e urtë thotë se "nuk mund të bëhesh zot shtëpie në shtëpi të huaj". Rrjedhimisht, nëse i drejtohesh kështu një të riu kosovar, i cili nuk sheh perspektivë për të ardhmen në vendin e tij, ai do të ndihet i fyer, ani pse kjo qëndron.

Atëherë pse të mos vetëdijesohemi edhe ne, pse të mos i vëmë vetes disa pikësynime për të ardhmen dhe të mburremi me sukseset tona, e mos ta boshatisim vendin tonë pa ndonjë arsye relevante? ■

Maqedonia në prag të zg



Musa LLAMALLARI

Në Maqedoni do të ketë zgjedhje të parakohshme parlamentare, që janë paralajmëruar më 5 qershor të këtij viti. Në kampin politik shqiptar interesat personale të individëve dhe grupacioneve të ndryshme, të cilët deformuan partitë e tyre dhe i keqmenaxhuan shqiptarët pas konfliktit të vitit 2001, janë shumë aktivë në prag të zgjedhjeve me një qëllim të vetëm: **të bëhen pjesë e ndonjë pushteti të ardhshëm, për t'i varfëruar shqiptarët edhe më shumë në Maqedoni.** Ndërsa pozita kushtetuese e shqiptarëve dhe sistemi unitarist i shtetit nuk paraqet asnjë shqetësim për këta individë dhe grupacione, që do të garojnë ndaras në këto zgjedhje dhe, pas zgjedhjeve, do të bëhen gazi i botës për servilizëm se kush do të futet më parë në qeverisjen e sistemit unitarist, e jo të refuzohet ky sistem në start, që udhëhiqet nga një grup shumë i vogël i klasës elitare sunduese sllave në Maqedoni.

Kjo klase sunduese elitare, e ndarë në LSDM dhe VMRO, po mundohet të paraqitet se ka konflikt të papajtueshëm substancial me udhëheqjen e shtetit, por jo edhe të rregullimit dhe të ndryshimit të sistemit në qeverisje. Mirëpo, e vërteta është ndryshe. Ata, së bashku në emër të një shteti hibrid, por unitar dhe antidemokratik, janë në funksion të shërbimeve sekrete serbo-ruso-bullgare, por edhe greke, pasi jemi dëshmitarë se refuzimi i kërkesave të shqiptarëve, të grupeve të tjera etnike nga këta dy taborë nuk ka ndryshuar asnjë milimetër prej kohës së shpërbërjes së Jugosllavisë.









Marrëveshja e Ohrit, Marrëveshja Politike dhe Marrëveshja e Biznesit janë ofertat që u ofrohen shqiptarëve të Maqedonisë në zgjedhjet e parakohshme nga Ali Ahmeti, Menduh Thaçi dhe Imer Selmani. Këta liderë kanë përgjegjësi të madhe ndaj qytetarëve shqiptarë në Maqedoni. Nëse kanë vetëdije, **"din dhe iman"**, ose kanë ruajtur një grimcë të moralit të tyre njerëzor, duhet që të tre të mblidhen bashkërisht në një konferencë dhe të dalin para shqiptarëve dhe t'u kërkojnë falje për të gjitha të këqijat që kanë ardhur si rezultat i bajraktarizimit, mosdijes dhe interesave të ngushta të tyre personale. Fajësisë së tyre mund t'u bash-

jedhjeve të parakohshme

këngjiten edhe disa të tjerë, që janë të renditur rresht në grupacionet e këtyre tri partive që tjetërsuan më herët interesat vitale të shqiptarëve në Maqedoni: elementin shtetformues, sovranitetin e plotë. Pa sovranitetin e plotë të shqiptarëve, vetëm si minoritarë ose si përqindje, Maqedonia mbetet një katalizator krizash të reja në Ballkan.

Maqedonia nuk respekton të drejtat e njeriut, nuk përkujdeset njëlloj për të gjithë qytetarët, nuk investon në mënyrë të barabartë në të gjithë territorin e vet, nuk ka ndarje të drejtë territoriale, nuk kërkon sistem funksional që i përgjigjet kërkesave të qytetarëve, kurse klasa sunduese sllave (e 20 për qindëshit), kjo kupolë e krimit, me pjesëmarrjen e përqindjeve simbolike të shqiptarëve në qeveri, as që çan kokën të kërkojë alternativa euroatlantike për zgjidhjen e problemeve, nuk investon asnjë qindarkë euro në ardhmëri, përkundër faktit që shumë fondacione euroamerikane kanë përfunduar në destinacione të dyshimta.

Maqedonia, gjithashtu, që nuk është shtet demokratik por sistem unitar, po shkatërron më shumë të ashtuquajturit maqedonas sllavë (nëse ka) që kërkojnë një shtet me koncept evropian, por edhe ata nuk janë seriozë në kërkesat e tyre: disa e shohin pengesë Ahmetin dhe jo Gruevskin, disa Thaçin, disa tash e shohin pengesë Selmanin, Obamën ose Mesihin e rrejshëm. Këta të tre po i shohin pengesë edhe miqtë tanë në Evropë dhe Amerikë. Shërbimet sekrete serbo-ruso-bullgare edhe forcave progresive sllave ua kanë ngulfatur veprimin dhe i kanë lënë si pula pa kokë. Kryeministri i Maqedonisë, kukulla e Sashës, nuk është kryeministër i shqiptarëve. Himni dhe stema ndërrohen sa herë t'i teket klasës sunduese sllave, kurse për emrin s'mund të ketë kompromise!? Greqia nuk është e gatshme për kompromise se shërbimi sekret grek i kontrollon të gjitha institucionet dhe biznesin përmes Gruevskit. Kurse akoma ma ironike është kur Ahmeti respekton këtë ndjenjë për identitet improvizues të Gruevskit!

Shqiptarët janë zënë ngushtë në këtë godinë artificiale: në Maqedoninë sllave të shërbimeve sekrete serbe-ruso-bullgare. Mbi fatin e shqiptarëve, në emër të qeverisë, vendosin këto shërbime. Por akoma edhe më keq, fati i tyre përbuzet nga përfaqësuesit e vet, që rrinë si mumie në atë Qeveri.

A kanë fuqi shqiptarët e Maqedonisë ta ndalin këtë të keqe të shërbimeve sekrete serbo-ruso-bullgare? A kanë shqiptarët arsenal të dijes ta dekonspirojnë emrin: Sasha? Por, për momentin me këta tre liderë: Ahmetin, Thaçin, Selmanin, nuk mund të kalohet as prej pyetjes në përgjigje, e lëre të kalohet Çupërlija dhe të arrihet te vatra e kulturës pellazgo-ilire në Manastir.

Këtu vijmë te konstatimi: Atëherë ku janë miqtë tanë perëndimorë? Pse heshtin? Ku është Amerika? Unë them: Amerikën aty e kemi, shumë afër. Ku janë shqiptarët, është Amerika, është Anglia, edhe një pjesë e Evropës. A nuk ishte ambasadori anglez i pari në vitin 2001 që na paralajmëroi për punën e Ali Ahmetit se është punë e shërbimeve sekrete serbo-ruso në Maqedoni? Besoni se nuk thirrem dhe nuk ju besoj aferës së dosjeve, por deklaratës së ambasadorit tim britanik në Shkup: Po.

E atëherë kush mund të na ndihmojë? A ka kush që të na dalë në ndihmë që ta ndalim politikën defitiste të përfaqësuesve shqiptarë në Maqedoni, që fund e krye janë në vijën e shërbimeve sekrete serbo-ruso-bullgare? (Ndoshta pa-





vetëdije, Zot bëje ëndërr!) Në mars dhe prill **Komuniteti Shqiptaro-Amerikan i Çikagos**, i udhëhequr nga Iljaz Kadriu dhe disa aktivistë shqiptarë që jetojnë dhe veprojnë në Diasporë, nga ndjenja e çiltërsisë, në bashkëpunim dhe me përkrahjen e miqve tanë në SHBA dhe Evropë, kanë vizituar Maqedoninë, kanë pasur takim me të gjitha partitë shqiptare, shoqatat dhe grupet e ndryshme, komunat shqiptare, me BFI, gjithashtu kanë paraqitur edhe platformën e tyre shtatë pikëshe për unifikimin e spektrit politik shqiptar, kanë pasur edhe kërkesa reale për njerëzit që duhet të jenë në lista të partive në këto zgjedhje parlamentare. Kërkesat e tyre kanë qenë pothuajse në stilin e njëjtë, si zarfi i ambasadorit Dell për zgjedhjen e Presidentit të Kosovës! Këta veprimtarë shqiptarë nga SHBA kanë vetëm një porosi: duhet të zgjidhen më të mirit dhe në listat e këtyre zgjedhjeve parlamentare të futen më të paluhatshmit, ata që vijë politike nesër do të kenë interesin euroatlantik dhe jo tenderat e shërbimeve sekrete serbo-ruso-bullgare në Maqedoni. Të refuzohet kjo platformë nga partia e Ali Ahmetit, të sulmohet Xhevat Sherifi për deklaratën e tij vetëm pse tregon për mediat se Ali Ahmeti s'di, s'do dhe s'mund të bëjë më shumë për shqiptarët, të shikohet me rezervë ardhja e tyre nga partia e Menduh Thaçit, kurse edhe më keq të shkelet zotimi i dhënë i Imer Selmanit para përfaqësuesve të Komunitetit Shqiptaro-Amerikan, për një tender 15 milionë euro për furnizim me karburante të policisë së Maqedonisë, që është kryekëput në funksion të shërbimeve sekrete serbo-ruso-bullgare. Vërtet është tradhti kombëtare, por edhe një shuplakë indirekte kundër miqve tanë në Senat dhe Kongres.

Vallë, a thua e di ku ka rënë Imer Selmani me këtë veprim mashtrues? Komuniteti Shqiptar nga SHBA nuk ia imponuan askujt platformën, por kërkuan unifikim të spektrit politik shqiptar në Maqedoni në realizimin e saj. Karadaku dhe Shkupi nuk blihet me 15 milionë euro, njerëzit në Karadak, Kumanovë dhe Shkup në vitin 2001 ja dhanë bijtë më të mirë Ali Ahmetit, dhanë edhe pasurinë, edhe shtëpitë e tyre në emër të idealeve kombëtare, por jo të milionave, atëherë kur Ali Ahmeti s'kishte miliona, siç i ka sot të fshehura në sorrollakun e familjes së tij, në kupolën e krimit që për 10 vjet shkatërruan çdo gjë, sakatuan dhe vranë dhe nuk e ndriçuan asnjë vrasje politike (por së shpejti do të ndriçohen të gjitha!).

E çka duhet të bëjmë, atëherë? Kënd të votojmë, të dilet apo jo në zgjedhje? A ka shpresa të reja apo do të na rishfaqen të njëjtit persona me të njëjtin avaz të korrupsionit, krimit, shantazheve dhe larjes se hesapeve të pista, ku çdoherë viktimë do të jenë qytetarët e pafajshëm shqiptarë?

Do të kishte qenë mirë që kërkesat e Komunitetit Shqiptaro-Amerikan të mos refuzohen, por të pranohen nga ndonjë subjekt politik shqiptar në Maqedoni. PPD është shprehur e gatshme ta ofrojë partinë komplet në shërbim të këtyre kërkesave, po ashtu edhe partia e re e Rufi Osmanit nuk ka dhënë shenja refuzuese për bashkëpunim parazgjedhor me kërkesat e Komunitetit Shqiptaro-Amerikan. Atëherë pse nuk provohet? Është mirë që në këto zgjedhje të bëhet një koalicion i përbashkët rreth platformës politike të Komunitetit Shqiptaro-Amerikan, një koalicion që do të ndërtonte një koalicion tjetër të madh dhe të lidhur direkt me qytetarët shqiptarë në Maqedoni. Ky koalicion i madh **"Bashkë!"**, i lidhur me qytetarët shqiptarë, do të kishte dy mundësi:

1. Pjesëmarrje në zgjedhje, por me kërkesa ultimative drejtuar Gruevskit dhe Cërvenkovskit për të gjitha çështjet...
2. Mospjesëmarrje dhe thirrje për bojkot të shqiptarëve dhe grupeve tjera etnike. ■



Intervistë me ministrin e jashtëm, Enver Hoxhaj

HOXHAJ: PËR KOSOVËN LOBIM DHE PËRMIRËSIM TË IMAZHIT

Intervistoi: Muhamet JAHIRI

Është numri një i diplomacisë kosovare, i cili e ka nisur këtë punë me vullnet dhe entuziazëm të jashtëzakonshëm. Premton se do të japë shumë për Kosovën, do të punojë edhe jashtë orarit të tij, për ta përmirësuar imazhin e Republikës së Kosovës dhe për t'i sjell vendit sa më shumë njohje. Është njeriu i cili ka hartuar strategji për diplomacinë e jashtme dhe ka thënë se do të lobojë shumë për t'i sjellë Kosovës njohje të reja. Sipas tij, institucionet e shtetit do të angazhohen më shumë në punën e tyre, në mënyrë që Kosova t'i sigurojë njohjet edhe nga pesë vendet e Bashkimit Evropian, të cilat ende po hezitojnë. Për më shumë flet në një intervistë për revistën "Paqja", ministri i jashtëm i Republikës së Kosovës, Enver Hoxhaj.


Enver Hoxhaj
Ministër i jashtëm i Kosovës

PAQJA: ***Z. Hoxhaj, që nga fillimi i mandatit tuaj keni folur rreth hartimit të një strategjie lobuese. A mund të na thoni për çka bëhet fjalë më konkretisht?***

Hoxhaj: Prioriteti ynë i parë është rritja e numrit të njohjeve për Republikën e Kosovës, meqë vendi ynë ka nevojë për më shumë njohje. Mendoj se gjatë kësaj kohe është bërë një punë shumë e madhe në arritjen e njohjeve të caktuara, por tash do të fokusohem në atë se si do të bashkëpunojmë me shtetet të cilat e kanë njohur Kosovën, të cilat mund të lobojnë për njohje të reja. Në kuadër të strategjisë, e cila ka marrë mbështetjen e Qeverisë, në procesin e lobimit për njohje nuk parashihet vetëm angazhimi i MPJ-së, ambasadorëve, por do të përfshihen edhe shumë personalitete të ndryshme nga jeta publike, politike e shoqëria civile, të cilët mund të lobojnë për Kosovën. Këto personalitete do të jenë të emëruar të posaçëm, të cilët do të kenë një agjendë të qartë dhe do të shkojnë nëpër vende të botës, varësisht prej lidhjeve dhe raporteve të tyre me shtete të caktuara. Është e rëndësishme se ne angazhohemi të kemi një qasje, e cila përshin sa më shumë njerëz në procesin e lobimit. Po ashtu, do të angazhojmë edhe shumë miq të Kosovës në vende të ndryshme të BE-së dhe SHBA-ve dhe në pjesë të tjera të botës që ta ndihmojnë Kosovën në aspektin e njohjeve.

PAQJA: ***A do të ketë ndonjë pikë tjetër të përfshirë në këtë dokument të strategjisë, apo do të merret ekskluzivisht vetëm me lobimin?***

Hoxhaj: Po, nëpërmjet kësaj strategjie parashihet promovimi i Kosovës në rrafshin dhe imazhin modern, duke i promovuar vlerat e saj kulturore. Prandaj, për të arritur këtë duhet të punohet në mënyrë intensive që, nëpërmjet formave të ndryshme, me njerëz të ndryshëm, Kosova të jetë e pranishme në çdo cep të botës. Pra, Kosova të jetë e pranishme në çdo forum ndërkombëtar dhe në çdo organizatë.

PAQJA: ***Pse i ka munguar deri më tani Republikës së Kosovës një dokument i tillë?***

Hoxhaj: Deri më tani Kosova nuk ka pasur ndonjë dokument të definuar si strategji nëpërmjet së cilës do të punohet në rrafshin strategjik. Nëpërmjet kësaj strategjie do të definohet se në cilat pjesë të botës duhet të fokusohemi, pra kush mund të ketë ndikim në cilëndo pjesë të botës në mënyra të ndryshme. Në këtë rrafsh, shumë gjëra nuk mund të bëhen publike, pasi politika e njohjes nuk është shumë publike. Shumë shpejt do të mbahet një konferencë e nivelit të lartë ndërkombëtar në Zvicër, e cila ka



të bëjë me mënyrën se si të preventohet gjenocidi. Ne, si MPJ, do të dërgojmë një njeri eminent, i cili do ta përfaqësojë Kosovën dhe do ta prezantojë atë se çfarë ka ndodhur në të kaluarën në Kosovë, dhe çka nënkupton rasti i Kosovës për fenomene të njëjta me pjesë të tjera të botës. Kjo do të thotë se çështja e politikës së jashtme nuk është vetëm çështja e marrëdhënieve bilaterale diplomatike në mes të dy shteteve, por përfshin shumë nivele.

PAQJA: ***Z. Ministër, a mund të na thoni se a keni zgjedhur personelin për lobim, si dhe a mund të na thoni se në cilat vende do ta nisni lobimin për njohje?***

Hoxhaj: Për hir të procesit nuk do të flasim më shumë për këtë çështje. Vetëm mund t'ju them se realisht jemi duke biseduar edhe me personalitete të tjera, të cilat kanë ndikim në vende të ndryshme. Ka një plan operacional, një listë të emrave, dhe të vendeve se ku dhe kush do të shkojë për të lobuar për njohjen e Kosovës. Deri më tani veç janë marrë kontaktet e para në shumicën e këtyre shteteve. Por, mos insistoni për të dhënë më shumë detaje.

PAQJA: ***A mund të na tregoni më shumë rreth personaliteteve të përfshirë në këtë fushë lobuese, apo janë njerëz tashmë të ditur?***

Hoxhaj: Në politikën e jashtme, përveç ministrit, njerëzve të tjerë të ministrisë, ambasadorëve, duhet të jenë edhe shumë njerëz të tjerë të cilët duhet të përfshihen. Praktikohet të ketë edhe të emëruar të posaçëm, të cilët kanë detyrë të caktuar ta përfaqësojnë Kosovën qoftë në ndonjë organizatë a institucion tjetër të fuqishëm ndërkombëtar. Do të ketë edhe ambasadorë jorezidentë, të cilët kanë fokus të gjerë. Do të kemi edhe konsuj nderi. Do të kemi, po ashtu, edhe ambasadorë nderi, të cilët do të operojnë në disa nivele. Këto janë çështje të cilat do të përmblidhen në një strategji, pastaj ne, gjatë këtyre katër vjetëve të ardhshëm, do të bëjmë përpjekje maksimale ta jetësojmë këtë strategji. Ne kemi një dokument shumë të detajuar për atë se çfarë lëvizjesh politike ka në shtete të caktuara, cili është qëllimi i tyre për Kosovën, sa janë të gatshëm për ta njohur Kosovën, pse nuk e njohin Kosovën, kush mund të ketë ndikim te këto vende për ta njohur Kosovën, etj.

PAQJA: ***Si mendoni t'ia sillni Republikës së Kosovës njohjet nga pesë vendet e BE-së, njohje të cilat në një mënyrë janë edhe duke e penguar Kosovën për ecjen drejt BE-së?***

Hoxhaj: Kuptohet se njohja e Kosovës nga këto pesë vende të BE-së është nju njohje kyçe. Përveç kësaj, për neve është shumë e rëndësishme që Republika e Kosovës të njihet nga sa më shumë shtete të tjera në botë. Gjithashtu, është po aq shumë e rëndësishme që Kosova të përfaqësohet në sa më shumë organizata të ndryshme të botës, që janë të karaktereve të ndryshme politike, ekonomike, kulturore e sportive. Për ne është po aq e rëndësishme t'i përfaqësojmë dhe t'i promovojmë interesat e shtetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Strategjia nuk është hartuar ende, por është marrë vetëm vendimi për hartimin e saj, prandaj është në proces hartimi se cila do të jetë qasja e Kosovës karshi këtyre pesë vendeve të BE-së, të cilat ende s'e kanë njohur Republikën e Kosovës.

PAQJA: ***Keni menduar që ta angazhoni edhe ndonjë kompani lobuese në këto vende të BE-së, për t'i bindur ato që ta njohin Republikën e Kosovës?***

Hoxhaj: Edhe kjo është një çështje e cila do të definohet në strategjinë lobuese. Brenda strategjisë do të parashihen se cilët do të jenë mekanizmat lobues dhe qëllimet e tyre. Është e rëndësishme se kjo strategji e ka marrë përkrahjen financiare nga qeveria.

PAQJA: ***Mund të presin qytetarët një njohje në 100 ditët e para të qeverisjes suaj në krye të MPJ-së?***

Hoxhaj: U premtoj qytetarëve të Kosovës se do të punoj 15 orë në ditë. Sa i përket njohjes, ajo është akt i njëanshëm i shtetit të caktuar, prandaj njohja nuk është dëshirë e ministrit të jashtëm. Por, do të punoj 15 orë në ditë që, së

pari, t'i përfaqësoj interesat shtetërore të Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare, t'i përfaqësoj interesat politike dhe ekonomike të vendit, si dhe interesat e qytetarëve në çdo cep të botës.

PAQJA: ***Cilat do të jenë prioritetet tuaja kryesore gjatë këtij mandati qeverisë?***

Hoxhaj: Kemi pesë prioritete kryesore: rritjen e numrit të njohjeve, vendosjen e marrëdhënieve diplomatike bilaterale, rregullimin e marrëdhënieve ekonomike, integrimet euroatlantike, si dhe anëtarësimin e Kosovës në organizata të ndryshme të botës. Të gjitha këto janë prioritete shumë kyçe për Republikën e Kosovës, prandaj besojmë se me punë do t'i arrijmë.

PAQJA: ***Kemi dëmtim të imazhit të Kosovës, sidomos kohëve të fundit. Çfarë do të bëni për ta përmirësuar këtë imazh të Kosovës në skenën ndërkombëtare?***

Hoxhaj: Puna parësore e MPJ-së është që të prezantojë një imazh modern, real dhe objektiv, se si është Kosova. Mos t'u lejojmë të tjerëve të krijojnë një imazh negativ për vendin tonë. Në muajt e fundit ka pasur zhvillime të cilat nuk kanë qenë pozitive për Kosovën, por mendoj se kanë qenë veprime të planifikuara për ta dëmtuar reputacionin e shtetit tonë në arenën ndërkombëtare. Duke pasur parasysh këto, do të bëjmë të pamundurën që gjatë kësaj kohe ta prezantojmë imazhin real të Kosovës.

PAQJA: ***Si e vlerësoni dialogun e nisur mes Kosovës dhe Serbisë?***

Hoxhaj: Ky dialog është zhvilluar në mes të dy vendeve të pavarura dhe sovrane, në karakter teknik. Ky dialog nuk do të ndikojë negativisht në asnjë formë në pozitën ndërkombëtare të Kosovës. Jam shumë i sigurt se edhe gjatë kësaj kohe do të ketë zhvillime pozitive për Kosovën. Për mendimin tim, dialogu mund të përdoret si një instrument shumë i mirë për ta forcuar pozitën e Kosovës karshi Brukselit. Nga ky dialog besoj se do të kemi lëvizje pozitive për liberalizimin e vizave dhe do të fillojnë shumë procese të rëndësishme për integrimin evropian të Kosovës.

PAQJA: ***Z. Hoxhaj, e keni nisur vizitën e parë në cilësinë e kryediplomatit kosovar në SHBA. Si e vlerësoni këtë?***

Hoxhaj: SHBA-të kanë dhënë kontribut të çmueshëm për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Roli amerikan për forcimin e shtetit të Kosovës është i një rëndësie të veçantë. Nisur nga ky fakt dhe zhvillimet aktuale, e kam parë të arsyeshme që vizitën e parë si shef i diplomacisë kosovare të bëj në Uashington. Gjatë kësaj vizite, së bashku me zëvendëskryeministren Edita Tahiri, kemi pasur një agjendë aktive, me ç'rast kemi takuar zyrtarë të lartë të shtetit amerikan. Kjo vizitë ka pasur për objektiv forcimin dhe zgjerimin e marrëdhënieve shumë speciale në mes të shtetit të Kosovës dhe SHBA-ve. Në këtë kuadër, kemi kërkuar vazhdimin e mbështetjes prej SHBA-ve për forcimin e pozitës ndërkombëtare të shtetit tonë, si dhe integrimin euroatlantik të Kosovës. Kemi shkuar atje për t'i promovuar marrëdhëniet e mirëfillta ekonomike, kulturore e sportive. ■



SHQIPTARËT SHEMBULL I TOLERAN



Muhamet JAHIRI

Për dy ditë radhazi në Tiranë është mbajtur Simpoziumi Ndërkombëtar me temë "Këndvështrimi i Diversitetit Fetar, Kulturor e Shoqëror në Ballkan nga Perspektiva Globale – Përvoja e Fetullah Gylenit si Model dhe Harmonia Ndërfetare në Shqipëri". Në këtë Simpozium, të organizuar nga Universiteti i Tiranës, Universiteti Fatih i Stambollit, Qendra e Dialogut "Prizma", nën përkujdesjen e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit (TKRS), kanë paraqitur referatet e tyre tridhjetegjashtë akademikë dhe shkencëtarë nga tetëmbëdhjetë vende të ndryshme të botës, ndër ta edhe dy nga Kosova.

Me këtë rast Ferdinand Xhaferaj, ministri i TKRS, në hapje të simpoziumit ka falënderuar të pranishmit duke thënë se Shqipëria mburret për tolerancën ndërfetare dhe është një rast i veçantë i diversitetit ndërfetar. "Harmonia ndërfetare në Shqipëri jo veçse është një rast unik, por edhe vlerë e kombit tonë. I kemi kushtuar një rëndësi të veçantë ruajtjes dhe tolerancës ndërfetare, Shqipëria konsiderohet si njëri ndër vendet e pakta në botë ku diversiteti ndërfetar çmohet më shumë se kudo në botë", - ka thënë Xhaferaj

Xhaferaj ka thënë se në këtë simpozium janë duke u trajtuar çështje të rëndësishme, të cilat kanë rol të veçantë për krijimin dhe ruajtjen e paqes botërore. Ai ka çmuar lart udhëheqësin e paqes dhe tolerancës ndërfetare Fetullah Gylen për thirrjet e vazhdueshme të tij për paqe dhe dialog në gjithë botën. "Shpresoj se përpjekjet e njerëzve si Gylen, për zgjatjen e dorës dhe për përpjekjet për një botë të lumtur, do të na bartë e do të na bashkojë ne, kulturat dhe qytetërimet nëpër horizonte të ndritshme" - është shprehur ai duke shtuar se njerëzimi do ta arrijë bashkimin si rezultat i nevojës për paqe, sepse njerëzimi është lodhur me probleme dhe luftëra.

Kule: Diversiteti ndërfetar pasuri e shqiptarëve

Ndërkaq, nikoqiri i simpoziumit, rektori i Universitetit të Tiranës Dhori Kule, në fjalën e tij ka theksuar se në botën e sotme diversiteti ndërfetar është mbushur me armë e luftëra. Kule ka thënë se Shqipëria mbetet ndër vendet e pakta në botë ku ka një tolerancë ndërfetare të një niveli të lartë dhe se ajo mburret me një gjë të tillë.

"Sot jemi në një vend si Shqipëria i cili ka qenë diamanti i kulturës, ku kemi parë se mund të prodhohet bashkëjetesa dhe diversiteti ndërfetar. Diversiteti është pasuri për shqiptarët, sepse po jetojmë në një botë kur një gjë e tillë po nxit shumë urrejtje dhe dhunë", - ka thënë Kule duke shtuar se Shqipëria vazhdon të mbetet mit dhe shembull për shumë vende të botës për tolerancë dhe diversitet ndërfetar."Shqipëria ka qenë dhe vazhdon të jetë mit i bashkëjetesës dhe tolerancës fetare. Shqipëria dhe shqiptarët, ky komb i vogël në botë janë një shembull i madh sesi besimet fetare jetojnë vëllazërisht në të njëjtin qiell", - është shprehur ai.

Ndër të tjera rektori Kule ka çmuar lart punën dhe veprimtarinë e njeriut të tolerancës dhe paqes Fetullah Gylen, duke thënë se ai është shembulli më i mirë se si mund të zgjidhen problemet përmes paqes. "Fetullah Gylen ka qenë dhe vazhdon të jetë një mendimtar dhe një avokat i paqes dhe bashkëjetesës. Ai është modeli që promovon dhe sjell së bashku në një sofër, në një tryezë krishterimin, islamin dhe hebraizmin

CËS DHE DIVERSITETIT NDËRFETAR

dhe qindra kultura dhe etni që ato mbajnë brenda tyre", - ka deklaruar Kule.

Krasniqi: Idetë e Gylenit burojnë nga Islami tolerant

Në simpozium është paraqitur me referatin e tij edhe profesori i Universitetit të Prishtinës, Milazim Krasniqi, i cili ka thënë se Shqipëria është duke vuajtur nga mungesa e një tolerance politike, prandaj edhe simpoziumi mbi vlerat dhe për tolerancën do të ishte një shembull i mirë për ta. Profesor Krasniqi, duke folur për tolerancën dhe diversitetin ndërfetar, ka çmuar lart punën dhe veprimtarinë e Fetullah Gylenit. "Idetë e Gylenit për tolerancë e për dialog përbëjnë shenjën më të qartë të identitetit të tij intelektual, moral e njerëzor. Veprimtaria e tij në të gjithë botën e ka bërë këtë person simbol të dialogut dhe tolerancës të përmasave botërore", - ka thënë Krasniqi.

Sipas tij, idetë e Gylenit burojnë nga Islami i mirëfilltë e tolerant. Zhvillimi dhe ndikimi i tyre ka kaluar një fazë të vështirë, duke u nisur së pari edhe nga vendi nga i cili ai vjen. "Interpretimi i ideve të Gylenit, të cilat burojnë nga Islami tolerant, ka kaluar në një fazë shumë të vështirë, së pari nga vendi i tij, i cili ka kaluar një fazë shumë të vështirë pa e zgjedhur ekuilibrin e vet në mes gjeografisë, historisë dhe të ardhmes", - ka theksuar Krasniqi, duke shtuar se: "Ai e ka kuptuar se ndryshimi nuk vjen nga konfrontimi dhe nga hakmarrja, por nga toleranca dhe dialogu brenda fetar. Ai i ka promovuar në vlerat e tij idetë e tolerancës, dialogut, tolerancës fetare dhe të drejtave të njeriut".

Një problem tjetër për përhapjen e ideve të Gylenit, sipas Krasniqit, ka qenë edhe ai në rrafshin ndërkombëtar, e sidomos pas sulmeve të shtatorit në ShBA.

"Më i vështirë për Gylenin ka qenë pranimi i ideve të tij në vendet ndërkombëtare, veçmas pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit, kur ka pasur mungesë të imponimit të ideve të tilla. Botimi i mijëra artikujve me frymë anti-islame në mijëra gazeta, përdorimi i karikaturës në mënyrë anti-morale, i la pafrymë shumë intelektualë për një kohë të gjatë", - është shprehur Krasniqi në analizën e tij, duke shtuar se për një kohë të gjatë ka qenë e vështirë të shtjellohej ajo që kishe ndodhur më njëmbëdhjetë shtator, gjë e cila nuk kishte të bënte aspak me Islamin, por që ishte një veprim antinjerëzor dhe një keqinterpretim.

Krasniqi ka thënë se Gyleni, me mençurinë dhe filozofinë e tij mbi paqen dhe diversitetin ndërfetar, më vonë ka arritur t'i imponojë idetë e tij. "Idetë e Gylenit se muslimani nuk mund të jetë terrorist dhe se terroristi nuk mund të jetë musliman ka qenë njëra nga ato gjeste që i ka shtyrë shumë mendje të ngjeshura që të mendojnë më racionalisht. Më pas idetë e Gylenit filluan të funksiononin në mënyrë më racionale dhe si alternativë serioze", - është shprehur profesor Krasniqi.

Tërnava: Gyleni fitoi zemrat e miliona njerëzve

Ndërkaq, të pranishmit i ka përshëndetur me një fjalë rasti edhe kreu i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), Naim Tërnava, i cili me këtë rast e ka çmuar lart kombin shqiptar për diversitetin dhe tolerancën ndërfetare.

"S'ka dyshim se begatia më e madhe e kombit shqiptar është bashkëjetesa ndërfetare. Ne, si komb i vogël, nëse nuk kemi mundësi t'iu ofrojmë kombeve të mëdha shumë në fushën e teknologjisë e arsimit, kemi mundësi t'ua ofrojmë përvojën tonë të bashkëjetesës ndërfetare, për të cilën bota ka nevojë të vazhdueshme", - ka thënë Tërnava, duke çmuar lart punën dhe veprimtarinë e Fetullah Gylenit.

"Të flasësh për një njeri të madh nuk nevojiten fjalë të mëdha, sepse edhe fjalët e thjeshta arrijnë madhështinë e tij. Njeriu i cili me karizmin e tij fitoi zemrat e miliona njerëzve, është ai i cili kthehet në një mendimtar e dijetar që bashkon shpirtin me shpresën në dobi të shoqërisë njerëzore", - është shprehur ai. Në këtë simpozium kanë paraqitur teoritë e tyre edhe shumë akademikë e profesorë nga vendet e ndryshme të botës si: Turqia, ShBA-të, Britania e Madhe, Rusia, Gjermania, Holanda, Indonezia etj. ■



RESTAURØHET MUZEU I PAVARËSISË

Ndriçim HOXHAJ

100 vjetori i pavarësisë do ta gjejë Muzeun Kombëtar të ridimensionuar. Si një nga objektet simbol Muzeu i Pavarësisë është përfshirë në listën e projekteve që do të duhet të realizohen me financime të veçanta nga qeveria shqiptare. Pika e parë e projektit ka të bëjë me kërkesën për ndërtimin e një godine të re, krahas asaj aktuale. Për hartimin e projektit specialistët janë bazuar në fotografi të vjetra. Kjo godinë e re do të shërbejë për ta çliruar muzeun nga hapësira që sot zë administrata e tij. Ambientet e godinës së re, përveç zyrave, do të shfrytëzohen për të shpërngulur aty arkivin e Muzeut të Pavarësisë, si dhe për të krijuar një sallë ekspozitash, në të cilën më së shumti do të prezantohen materiale publicitare, siç janë guidat. Projekti që tashmë gjendet në Institutin e Monumenteve të Kulturës për godinën ekzistuese parashikon vetëm disa ndërhyrje teknike që kanë të bëjnë me zëvendësimin e shkallëve prej graniti me shkallë druri, drenazh të objektit ekzistues, parmakë druri për ballkonin, restaurim i pusit të oborrit, por edhe instalimin e sistemit të kondicionuar. Ndërsa nëse kjo kërkesë do të kuptohej edhe si një ridimensionim i ekspozitës me dokumentacionin dhe objektet origjinale që ndodhen në këtë muze, drejtoria ka bërë kërkesë për një ekspozim bashkëkohor të dokumentacionit dhe për hartimin e një albumi të shpalljes së pavarësisë. Muzeu Kombëtar i Pavarësisë disponon mjaft objekte dhe dokumente origjinale. Së pari, objektet muzeore nisin me vetë godinën, e cila ka shërbyer si seli e Qeverisë Provizore të Vlorës. Rreth tre vite më parë, historiani vlonjat Bardhosh Gace dorëzoi në Muzeun Historik Kombëtar një fotografi që, sipas tij, tregonte shtëpinë e vërtetë ku u mblodh Qeveria e Vlorës. Në këtë muze gjendet kabineti i kryeministrit Ismail Qemali me mjaft objekte origjinale, si karrige, tavolinë, etazher, perdet, literaturë dhe foto familjare, si dhe fermanin në gjuhën osmanishte për emërimin në funksione të larta në Perandorinë Osmane. Të ekspozuara janë pullat e Postës Shqiptare me figurën e Skënderbeut, pjesë të aparatit Mors, përmes të cilit u dërguan telegrame ministrave të jashtëm të Fuqive të Mëdha për shpalljen e pavarësisë, kutia e duhanit e atdhetarit Isa Boletini, flamuj origjinalë të çetave patriotike të viteve 1905-1908, flamuri i çetës së Sali Butkës, fotografia e arritjes së Isa Boletinit, së bashku me bashkëluftëtarët kosovarë në qytetin e Vlorës, foto e qendrës së qytetit të Vlorës e vitit 1912, foto e vitit 1913 gjatë përshëndetjes së popullit nga Ismail Qemali dhe anëtarët e qeverisë në ballkonin e kësaj godine, pushkë të ushtarëve të Qeverisë Provizore, shpata të kësaj periudhe etj. Në fakt, në prag të 100-vjetorit të pavarësisë është normale të presësh të shohësh në këtë muze objekte, dokumente apo fotografi origjinale të panjohura deri më tani. Stafi i muzeut është angazhuar totalisht për pasurimin e dokumentacionit dhe objekteve historike në bashkëpunim me të gjitha institucionet e fushës dhe me dashamirës të muzeut, të cilët disponojnë materiale dokumentare dhe objekte historike të kësaj periudhe. Ismail Qemali pa mëdyshje është figura kryesore e pavarësisë sonë kombëtare.

Muzeu Kombëtar i Pavarësisë është një destinacion turistik i pashmangshëm, sidomos për shqiptarët. Gjatë këtyre viteve më të interesuarit kanë qenë shqiptarët e Kosovës. Vetëm gjatë vitit 2010 ka pasur gjithsej 4914 vizitorë, nga të cilët një pjesë e konsiderueshme nxënës dhe studentë (rreth 2632, rreth 984 vizitorë vendas dhe 1298 vizitorë të huaj). Godina ku është vendosur Muzeu Kombëtar i Shpalljes së Pavarësisë në qytetin e Vlorës është ndërtuar në shekullin XIX. Ajo është një ndërtesë dykatëshe dhe ndodhet në afërsi të portit. Për rreth 6 muaj në vitin 1913, ajo shërbeu si rezidencë për qeverinë e parë shqiptare të drejtuar nga Ismail Qemali. Godina ka 8 dhoma dhe është pajisur me mobilie të shekullit kur është ndërtuar. Në mjediset brenda saj veçohen zyra e kryetarit të qeverisë, Ismail Qemalit, salla e mbledhjeve të kësaj qeverie etj. Më 28 Nëntor të vitit 1913, aty u përkujtua përvjetori i parë i shpalljes së pavarësisë. Për vlerat e saj arkitektonike e historike, ndërtesa është shpallur monument kulture. Katër vjet më parë, Muzeu i Shpalljes së Pavarësisë u shpall objekt muzeor kombëtar, në varësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë e Sporteve. ■



Paqja Studentore zgjodhi kryetarin e ri

Albert AHMETI

Paqja Studentore e Universitetit të Prishtinës, mbështetur në nenin 8.2 të statutit të kësaj organizate, ka organizuar kuvendin e IV-të zgjedhor.

Mandati i suksesshëm dyvjeçar i kryesisë së kaluar, i cili natyrisht që ishte vetëm pasim i një pune të suksesshme të gjeneratave të mëhershme, bëri që të shënohen sukseset më të larta të arritura në historinë e kësaj organizate.

Duke qenë të kujdesshëm që të mos pengohen studentët në mbarëvajtjen e ligjëratave, këshilli organizativ i këtij kuvendi i dalë nga kryesia e PS-UP-së, vendosi që kuvendin ta mbajë ditën e shtunë, ose më saktësisht me datën 12. 03. 2011, në orën 10:00, në Sallën e Kuqe. Ashtu qysh e parasheh rregullorja e punës së kuvendit në pikën 2, kuvendi duhet t'i ketë 51 delegatë, të cilët i përfaqësojnë 17 njësitë akademike të UP-së dhe të cilët vijnë në proporcion me numrin e studentëve të njësive përkatëse.

E gjithë procedura rrodhi sipas planit të paraparë. Pas përfundimit të pjesës ceremoniale, në të cilën ndër të tjera u nderuan me mirënjohje disa nga aktivistët më të dalluar të PS-UP-së në periudhën kohore 2008-10 dhe pas një kokteji për mysafirët, filloi procedura e mbajtjes së kuvendit me delegatët e pranishëm, të cilët zgjodhën me votat e tyre kryetarin e Kuvendit dhe 5 kandidatë potencialë për kryetar të PS-UP-së, njëri prej të cilëve do të merrte timonin e drejtimit të organizatës për mandatin dyvjeçar, i zgjedhur nga Bordi i kësaj organizate si organ mbikqyrës i punës së organizatës.

Pas votimit, në raundin e parë, për kryetar të kuvendit, ashtu siç e parasheh rregullorja e punës së kuvendit në pikën e 10-të, dolën dy kandidatë për kryetar: Pajtim Gashi dhe Leutim Sahiti. Më pas u mbajt raundi i dytë i votimit, nga i cili me shumicë absolute votash doli fitues Pajtim Gashi, i cili edhe u zgjodh zyrtarisht kryetar i Kuvendit për mandatin 2011-13.

Votimi për kryesinë e PS-UP-së, nxori 5 kandidatët potencialë për kryetar të organizatës: Besink Jaha, Ekrem Zajmi, Valon Zeka, Haris Hasani dhe Valdrin Kryeziu. Sipas nenit 6.8 të Statutit të organizatës, bordi obligohet që brenda 24 orëve t'i analizojë kandidaturat dhe të shpallë mandatarin për formimin e Kryesisë Qendrore të PS-UP-së.

Mbështetur në përvojën e mëhershme në strategjinë e organizimit dhe sukseset e treguara në këtë organizatë, kryetar i Paqes Studentore, për mandatin dyvjeçar 2011-13, u zgjodh Ekrem Zajmi. Bordi mbikëqyrës i përbërë nga 5 anëtarë, me unanimitet vendosi që Ekrem Zajmit t'i besohet mandati për formimin dhe udhëheqjen e kryesisë së re, e cila sipas nenit 11.1 të statutit të organizatës përbëhet nga 19 anëtarë. Ekremi është edhe përfaqësues në Parlamentin Studentor në radhët e Paqes Studentore.

Në intervistën e bërë me Kryetarin e sapozgjedhur të Paqes Studentore, Ekrem Zajmi, mësuam më shumë në lidhje me mbarëvajtjen e kuvendit dhe planet e tij për zhvillimin e mëtutjeshëm të organizatës. Ai thotë se kuvendi ishte organizuar në mënyrën më të mirë të mundshme, ngase puna në organizimin e tij ishte mjaftë e gjatë dhe natyrisht serioze.

Pyetjes sonë, lidhur me planet për të ardhmen e organizatës, ai iu përgjigj: "Ne kemi trashëguar nga gjeneratat e mëhershme një traditë të mirë pune dhe si të tillë duam ta vazhdojmë, natyrisht me punë dhe seriozitet edhe më të madh". Gjithashtu, sa i përket politikave të shtrirjes dhe zgjerimit të organizatës ai tha se: "Ne kemi pranë vetes shumë të rinj ambiciozë dhe të vendosur për ta çuar organizatën përpara, duke i fuqizuar të gjitha degët në 17 njësitë akademike të UP-së dhe vazhdimisht ka të rinj, të cilët i bashkohen vizionit tonë". "Për ne puna mbetet instrumenti i vetëm për ta marrë mbështetjen e studentëve dhe si të tillë do të vazhdojmë që të punojmë 12 muaj në vit, e jo vetëm atëherë kur na duhet vota e studentëve". Ai theksoi se kjo organizatë ka një traditë të mirë në funksionimin dhe përfaqësimin e denjë të studentëve të UP-së, duke u mbështetur në efikasitet dhe ndershmëri në punë.





Paqja Studentore ka numrin më të madh të uleseve në Parlamentin e Studentëve. Karakteristikë e kësaj organizate, për gjashtë vitet e funksionimit të saj, ka qenë se, edhe pse është njëra prej organizatave të themeluara pothuajse më së voni, ka arritur që me punën, angazhimin dhe seriozitetin e saj të marrë primatin si organizata më serioze në Universitetin e Prishtinës. Në zgjedhjet e vitit 2006, njëherësh në zgjedhjet e para për këtë organizatë, ishte radhitur si organizata e tretë më e fuqishme në UP, ndërsa në zgjedhjet e dyta studentore të mbajtura në prill të vitit 2008, e ka dyfishuar rezultatin, duke dalë si organizata studentore më e fuqishmja në UP, ndërsa në zgjedhjet e fundit studentore në maj të vitit 2010 Paqja Studentore doli organizata e parë me rezultat të trefishuar në raport me zgjedhjet e vitit 2006, duke i ikur 100% organizatës së dytë, sipas numrit të votave dhe si e tillë mori katër ulëse në Parlamentin e Studentëve, ndërkohë që organizatat e tjera morën më së shumti dy ulëse në PS. ■

MUAVIJE IBËN EBI SUFJAN
(-15 h.-61 h. ose 604-680)

NUK VENDOS TEK UNË SHPATA ATY KU MË DËGJOHET ZËRI DHE NUK E VENDOS ZËRIN ATY KU MUND TË FLAS. SIKUR MIDIS MEJE DHE NJERËZVE TË NA MBAJË NJË QIME FLOKU, NUK E KËPUS ATË. KUR ATA E KAPIN FORT UNË E LËSHOJ, KUR ATA E LËSHOJNË UNË E KAP FORT.

Muhamed J. KAJOLLI

Para se në këtë temë të përshkruhet biografia e këtij sahabiu, do të ishte e arsyeshme ta kemi përpara tabelën me emrat e dinastisë së themeluar prej tij. Osmani r.a i përkiste trungut familjar të emevitëve, mirëpo ky sahabij nuk konsiderohet si pjesëtar i dinastisë së kësaj familje për shkak se ky i përket katër Kalifëve të Drejtë, dhe atëkohë ende nuk njihej sistemi kalif-mbret.

Dinastia Emevite

Familja Ummeje				
Harb	Ebu As			
Ebu Sufjan	Affan	El Hakim		
Muavia (41-60)	Osman (23-35)	Mervan I-rë (64-65)		
Jezid (60-64)		Abdul Aziz	Abdul Melik	Muhammed
Muavia II-të (64-64)			1. el Velid	Mervan II-të (127-132) Këtu mbaron dinastia emevite
			2. Sulejman	
			3. Jezid II-të	
			4. Hisham	
	1. el Velid (86-96)	2. Sulejman (96-99)	3. Jezid II-të (101-105)	4. Hisham (105-125)
Jezid III-të (126-126)	Ibrahim (126-126)		El Velid II-të (125-126)	

Kush ishte Muavi ebu Sufjani?

Rinia e këtij sahabiu nuk është përshkruar në librat e historisë, sepse më parë nuk dihej asgjë për të. Emri i tij u bë i njohur vetëm atëherë kur ai e përqafoi Islamin në moshën 23 vjeçare, pra, në kohën e çlirimit të Mekës në vitin e tetë hixhrij.

Ai, që në vegjëlinë e tij, jetoi si aristokrat, sepse i përkiste familjes aristokrate (sipas kushteve të Mekës së atëhershme). Babai i tij Ebu Sufjani ishte gjithashtu aristokrat, sepse konsiderohej i pari i fisit kurejsh, mirëpo ky e mbaroi jetën e tij duke qenë i pari i shtetit me disa miliona kilometra katrorë. Nuk dihet saktë se cila ishte arsyeja e Muhamedit s.a.v.s. që e afroi shumë afër vetes së tij këtë djalosh.

Ndoshta për shkak se ishte djali i Ebu Sufianit, ose ndoshta ishte vërtet i shkathët. Sidoqoftë Pejgamberi s.a.v.s., për dy vjet sa jetoi, ia mundësoi këtij të ishte pjesëtar i grupit që të shkruante shpalljen e Kuranit me të tjerët. Transmetohet gjithashtu se, në një rast, Muhamedi s.a.v.s. paska bërë dua për Muavinë dhe paska thënë: *"O Allah, bëje të qetë, të qetësojë dhe udhëzo me të"*[1]. Nga shumë transmetues, gjithashtu, transmetohet se Muhamedi s.a.v.s. i ka thënë Muavisë: *"Nëse do të bëhesh udhëheqës, bëhu i mirë!"*[2]


Muaviu në një monedhë

Cilësitë e Muavisë

Muavija ishte një njeri i cili një kohë të gjatë qëndroi si udhëheqës ushtarak dhe, më pas, edhe si politikan. Kur një njeri qëndron në pozita të larta të shtetit për një kohë të gjatë, për të mund të flitet në mënyra të ndryshme. E kaluara e një njeriu të tillë përcillet me vepra të mira dhe të liga. Zoti na ruajt prej historianëve që kanë pasur qëllim të keq.[3] Sidoqoftë për të tregohet se ka qenë një politikan i mprehtë, se i njihte mirë problemet që e rrethonin, ishte i urtë dhe gojëtar i njohur. Ishte i butë në ditët e tij të qeta, i ashpër në kohëra të nxehta, mirëpo në përgjithësi butësia e tij binte në sy më shumë se vrazhdësia e tij. Ishte dorëlirë, mirëpo në të njëjtën kohë e dëshironte pa masë pushtetin.


Një rast, djali i Omeri r.a. tha: "Nuk kam parë njeri më dorëlirë se Muavija pas Muhamedit s.a.v.s. Atij i thanë, më dorëlirë se Ebu Bekri, Omeri, Osmani dhe Alia? Këta pa dyshim ishin shumë më të mirë se sa Muavija, mirëpo ky ishte më dorëlirë."[4] Ndërsa Omeri r.a. për Muavinë ka thënë: "Ky është sikurse Kisraja (mbreti) i Persisë".

Prej fjalëve të Muavisë janë edhe këto: "Nuk vendos tek unë shpata aty ku më dëgjohet zëri dhe nuk e vendos zërin aty ku mund të flas. Sikur midis meje dhe njerëzve të na mbajë një qime floku, nuk e këpus atë. Kur ata e kapin fort unë e lëshoj, kur ata e lëshojnë unë e kap fort."[5]

Që kur Ebu Bekri caktoi katër udhëheqësit më të mëdhenj ushtarakë në radhët e ushtrisë që do të luftonin perandorinë bizantine, në krye të ushtrisë islame të familjes emevite ishte Jezid ibn ebi Sufjan.[6] Kur ky një rast u ngushtua shumë dhe kërkoi ndihmë nga kalifi, Ebu Bekri i dërgoi ndihma ushtarake në të cilën komandant i tyre ishte vëllai tij Muavija. Pasi u çliruan disa territore dhe u stabilizua ushtria muslimane, në kohën e Omerit r.a., Jezidi u caktua prefekt i Damaskut, ndërsa Muavija u caktua prefekt i Jordanit. Muavija tregoi cilësitë e një udhëheqësi të lartë dhe të një politikani shumë të talentuar. Ai ishte shumë besnik.

Kur u vendos Osmani kalif, dhe pasi vdiq i vëllai i tij Jezidi, Muavija do të




Zgjerimi i Xhennetul Beki (Varrezave afër xhamisë së Pejgamberit a.s. në Medinë) në Kohëne Muaviut

emërohet Emir i Shamit (Sirisë, Libanit, Jordanit dhe i tokave të çliruara të Azisë së Vogël). Në këtë pozitë qëndroi njëzet vjet dhe kështu arriti të fuqizohet. Ai po i vendoste themelet e para të udhëheqësit të përgjithshëm në këtë territor të gjerë. Ishte njeriu i parë dhe i fundit, i cili udhëhoqi mbi këtë territor.

Pas vrasjes së Osmanit r.a., u vendos që Alia r.a. të merrte flamurin e shtetit, mirëpo Muavia nuk e njohu për të parin e muslimanëve dhe kështu shpërtheu lufta civile, në të cilën Muavia përfitoi pas atentatit që iu bë kalifit të muslimanëve, Alisë r.a. Pasi Hasani nuk i kishte cilësitë e Alisë r.a., ai e pa të udhës që t'ia linte Muavisë udhëheqjen e shtetit, dhe kështu Muavija do të sundonte shtetin me sipërfaqen më të madhe në botë. Në këtë post, Muavia do të qëndronte edhe për njëzet vjet të tjera.

Statusi familjar

Muavija ishte i martuar me shumë gra, mirëpo për grua kryesore kishte zgjedhur Mejsun, e cila ishte nga fisi Kelb. Si duket ajo ishte një poete e thjeshtë beduine dhe njëherësh edhe këngëtare. Ajo mendonte se djali i saj Jezidi duhej të edukohej sipas parimeve të vjetra arabe beduine dhe kohën më të madhe të jetës së saj e kaloi larg burrit. Më vonë sqarohet se Muavia këtë grua e kishte më së shumti për zemër, sepse djalin e saj Jezidin e shpalli trashëgimtar të fronit. Fatkeqësisht, vendimi i Muavisë që djali i tij të trashëgojë fronin pas babait të tij ishte jo i drejtë. Parimet islame nuk e këshillonin një gjë të tillë.

Ndryshimet gjatë udhëheqjes së Muavisë

Muavija, që në momentin kur u njoh si kalif i mbarë muslimanëve,[7] filloi çlirimin e tokave të cilat i ishin marrë gjatë angazhimit të tij në luftërat civile, prandaj Muavija nuk njihet si një udhëheqës i cili bëri ndryshime të mëdha brenda shtetit islam gjatë kohës njëzet vjeçare në të cilën sundoi. Por ngjarjet të cilat mbahen mend se ai kishte ndërmarrë ose ishte vetë themeluesi i tyre ishin:

- Duke qenë se Muavija kishte aftësi politike dhe administrative që e dallonin nga të tjerët, ai do të kërkonte nga administrata e tij regjistrimin e foshnjave të porsalindura. Ky vendim i tij ishte një hap shumë i mençur dhe kështu hapi dyert e një zhvillimi të ri.
- Në kohën e tij u formua edhe rrjeti postar në mbarë territorin e shtetit islam. Ai formoi pika të veçanta nëpër qendrat kryesore. Më herët, kur dikush caktohej të përcillte letër në një vend, ai do ta dërgonte atë derisa arrinte vetë atje, ndërsa që tani e tutje, postieri i ri e priste letrën nga postieri vjetër dhe ia përcillte postierit tjetër pa pasur nevojë pushimi.
- Një tentativë e Muavisë që u shkrua nëpër librat e historisë dhe e cila u quajt si shumë interesante, ishte përpjekja e tij për ta dërguar shkopin dhe mimberin e Pejgamberit s.a.v.s. në Damask. Ai, si pretekst, kishte marrë armiqësinë e vendasve ndaj kalifit Osman. Ai mendonte se mimberi dhe shkopi i Muhamedit s.a.v.s. duhej të ruheshin në Damask, mirëpo një gjë e tillë nuk iu lejua nga sahabët e mëdhenj. Pas tij ka pasur edhe të tjerë kalifë emevitë që kanë kërkuar një gjë të tillë, por edhe ata dështuan.
- Për herë të parë në historinë islame, dhjetë vjet para se të ndërronte jetë, Muavija caktoi birin e tij Jezidin për trashëgimtar të fronit. Ky veprim ishte në kundërshtim me zgjedhjen e kalifit të muslimanëve.

Muavija dhe çlirimet e tokave bizantine

Shteti musliman, pas pesë vjet katrahure, u ribashkua dhe kështu Mua-

visë iu hapën dyert e çlirimeve të reja. Ushtria islame ishte e motivuar fort për çlirime. Ato nuk vinin si nevojë materialiste siç thuhet nga historianë të ndryshëm për shkak të plaçkitjeve, por ata e kishin kuptuar mesazhin islam se janë të obliguar të përhapnin fenë e Allahut të Lartëmadhëruar anekënd botës. Jemi në kohën kur shumë sahabij ishin gjallë dhe shumë prej tyre kishin dëgjuar nga Muhamedi s.a.v.s. se muslimanët do ta çlironin Kostandinopojën.[8]

Vërtet, Muhamedi s.a.v.s. kishte paralajmëruar se Kostandinopojën do ta çlironte një udhëheqës, i cili do ta bartë emrin e një pejgamberi. Ai nuk kishte treguar se cili ishte ai. Prandaj secili musliman që kishte emrin e një pejgamberi do të ëndërronte që të merrte pjesë në çlirimin e kryeqendrës së Bizantit. Kështu çdo gjeneratë ka bërë përpjekje që të merrte pjesë në çlirimin e këtij qyteti shumë të rëndësishëm për përhapjen e Islamit në botë.

Ushtra islame, e cila kishte marrë drejtimin drejt tokave bizantine qysh në kohën e Pejgamberit s.a.v.s., më së shumti ishte përqendruar në familjen e emevitëve, jo për ndonjë arsye të rëndësishme, por për shkak se kjo familje kishte njohuri më të hollësishme mbi këto troje. Këto njohuri ju erdhën si rezultat i tregtisë së gjatë që kishin bërë emevitët me shtetin bizantin.[9]

Futuhatet – çlirimet

Para se të fillojmë të shpjegojmë rrethanat politike, betejat dhe ngjarje të tjera historike midis shtetit islam dhe atij bizantin, e shohim të udhës të shpjegojmë etimologjinë e fjalës 'futuhat'.

Për dallim nga interpretimet e ngjarjeve historike nga një pjesë e madhe e historianëve botërorë, muslimanët kanë një qasje krejtësisht tjetër. Që kur arabët, gjegjësisht muslimanët kanë filluar të shkruajnë historinë botërore, kam hasur në termin ose shprehjen 'futuhat'- çlirimet. Ky emërtim më befasoi dhe u mora më gjatë me këtë terminologji.

Historianët pers si dhe arabë "pushtimet" e Lekës së Madh nuk i quajnë pushtimet e Aleksandrit të Madh, por çlirimet e tij. Kjo më bëri përshtypje dhe u interesova të gjej shpjegimin logjik për këtë term. Babilonia, Egjipti dhe tokat arabe ishin të sunduara nga një pushtues despot dhe kur Aleksandri i Madh e mundi ushtrinë perse, ai i çliroi popujt e varfër nga perandoria e stërlodhur perse, e cila po i mbyste ata me tatime, si dhe i dërgonte nëpër beteja robërit të pastërvitur si ushtarë. Pastaj edhe Kurani na tregon një detaj shumë të rëndësishëm rreth Dhulkarnejnit (Lekës së Madh). Ai kishte për detyrë t'i çlironte popujt nga pushtetarët despotë. Ai e bëri këtë në shumë vende të botës.



Analoge me këtë ishin edhe 'pushtimet' arabe (islame). Ato po i shpëtonin popujt nga despotizmi bizantin. "Manueli u detyrua të tërhiqet në Kostandinopojë, ndërsa popullsia kopte e Aleksandrisë, me në krye patrikun monofizist Benjamin, iu nënshtrua vullnetarisht arabëve dhe e ratifikoi formalisht nënshtrimin e saj, duke deklaruar se preferonte më mirë zgjedhën arabe sesa atë bizantine."[10]

Këtë e kuptuam edhe më mirë, pasi mësuam më hollësisht rreth 'pushtimit' osman (si muslimanë) të trojeve tona. Derisa ata u sollën si muslimanë, askush nuk i provokoi, mirëpo kur osmanët u sollën si turq, pasi shpallën tanzimatin dhe zhvilluan projektin e tyre sipas mënyrës së jetesës turke dhe jo islame, filluan problemet. Shqiptarët, arabët dhe të gjithë popujt që jetonin nën ombrellën e shtetit osman, u çuan në kryengritje dhe për pak kohë e rrënuan atë pushtet.

Tani në Kosovë erdhi Aleanca ushtarake e NATO-s. Ajo na çliroi nga pushtuesi serb dhe na 'pushtoi'. Vallë, a mund të quhet vërtet ky pushtim? Me sa kujtojmë, të gjithë u gëzuam kur në Kosovë hynë ushtarët e NATO-s si çlirimtarë, mu sikurse hyrja e Aleksandrit të Madh në Babiloni e Egjipt, mu sikur osmanët tek ne para disa shekujsh. Prandaj, për shqiptarët, NATO-ja duhet të njihet si futuhat-çlirimtar, e jo si pushtues. ■

---

1 Ibn Ethir, "Usdul Gabe fi mearif esSahabe", redaktuar nga Muhamed Ibrahim El Bena dhe Muhamed Ahmed Ashur, L-5/f. 211

2 Ibn Ethir, "Usdul Gabe fi mearif esSahabe", redaktuar nga Muhamed Ibrahim El Bena dhe Muhamed Ahmed Ashur, L-5/f. 212

3 Për çdo gjë që them për këtë kalif të muslimanëve, e që nuk i përket atij, kërkoj falje filimisht nga Allahu i Lartëmadhëruar, pastaj prej tij në Ditën e Gjykimit. Qëllimi im është të zbardh historinë islame me qëllim që të mos biem pre e gabimeve të muslimanëve të hershëm, sepse jemi katandisur shumë keq si gjeneratë.

4 Ibn Ethir, "Usdul Gabe fi mearif esSahabe", redaktuar nga Muhamed Ibrahim El Bena dhe Muhamed Ahmed Ashur, L-5/f. 211

5 Ibn Abdu Rabi: "el Akdul el Ferdije" L1/ f. 29

6 Jezidi ishte vëllai i madh i Muavisë.

7 Ka mendime se Muavia e rrëmbeu postin e kalifit, por me sa duket ai u njoh nga tërë sahabët e mëdhenj si udhëheqësi i muslimanëve. Kjo do të vërtetohet më pas, sepse shumica e sahabëve do të merrnin pjesë në çlirimin e territoreve të reja, nën flamurin e ushtrisë muslimane të udhëhequr nga të zgjedhurit e Muavisë.

8 Meqenëse shteti islam ka një sipërfaqe shumë të gjerë dhe meqë kemi të bëjmë me një histori shumë të gjatë, lexuesve ju kërkoj falje që nuk jam përqendruar në ngjarjet rreth çlirimit të tokave drejt lindjes (Iranit, Pakistanit, Buharës, Horosanit, Indisë, Kinës…) dhe perëndimit (Egjiptit, Sudanit, Shteteve të Atllasit, Spanjës, Francës…). Si pikësynim kam Bizantin, e më vonë edhe Ballkanin. Kështu dua të arrij deri në trojet shqiptare.

9 Historianët tregojnë se Ebu Sufjani kishte pasuri të patundshme në Perandorinë Bizantine.

10 OSTROGORSKY, Georg, "Historia e Perandorisë Bizantine" B. Dituria 2007, f. 92-93

Demaskimi i mitit të 'Eurabisë'

John L. ESPOSITO,
Sheila B. LALWANI

Qendra për statistika Pew në një hulumtim për religjionin dhe jetën publike, së fundmi, ka bërë një studim të përgjithshëm për popullimin islam në tërë botën dhe sipas rezultateve të saj del se do të duhet të zbutet frika te shumë njerëz për një pushtim ose marrje islame në rrafsh global dhe kjo gjë demaskon botëkuptimet që kanë pasur për muslimanët. Rezultatet e studimit "E ardhmja e popullatës botërore islame: Projeksionet për 2010-2030" duhet ta nxisin publikun që ta marrë në konsideratë perceptimin për Islamin dhe muslimanët.

Skeptikët, posaçërisht ata në Evropë dhe Amerikën Veriore, për një kohë të gjatë kanë alarmuar për rritjen e popullatës islame.

Alarmantë të këtillë pretendojnë se Islami është një kërcënim demografik, duke paralajmëruar për një "Eurabi" të pashmangshme brenda disa dekadave. Kjo tablo, e një Islami triumfues mbi Evropën që ka humbur rrënjët e krishtera, ka kontribuuar në rritjen e partive politike anti-emigrante dhe anti-muslimane dhe në arritjen e një suksesi të theksuar të këtyre partive në zgjedhjet evropiane vitin e kaluar. Në Amerikë, kjo frikë filloi në fund të viteve '90-ta me artikuj që paralajmëronin "Muslimanët po vijnë, muslimanët po vijnë!" dhe duke vazhduar deri në debatin e fundit për Parkun 51 për një plan të ndërtimit të një qendre islame afër ground zero (ishkullat binjake në Nju Jork).

Kjo paranojë – e bazuar më shumë në frikë dhe keqkuptim – mbush Evropën dhe Amerikën me histeri anti-islame dhe anti-muslimane dhe minon shoqërinë tonë shumëkulturore.

Përderisa qendra Pew llogarit se popullata muslimane e botës pritet të rritet prej 1.6 miliardë gjatë vitit 2010 në 2.2 miliardë në vitin 2030, si qëndron çështja për një "valë islame" në Evropë?

Muslimanët do të mbesin relativisht një pakicë e vogël, por do të kenë një shpërndarje në rritje të popullatës së përgjithshme botërore. Duke u bazuar në këtë studim, popullata islame e Evropës është projektuar të rritet prej 44.1 milion sa ishte në vitin 2010 në 58.2 milion në vitin 2030. Rritja më e madhe pritet të shihet në Evropën veriore dhe perëndimore, ku muslimanët pritet të arrijnë përqindje dyshifrore. Për shembull, në Francë, popullata pritet të rritet nga 7.5 për qind sa është tani në 10.3 për qind.

Përhapja e muslimanëve në popullatën e SHBA-së është e projektuar të rritet nga 0.8 për qind sa ishte në 2010-tën në 1.7 për qind në 2030-tën, duke nënkuptuar se muslimanët do të ndajnë të njëjtat përqindje si hebrenjtë dhe episkopët. Është interesant se në SHBA pritet të ketë një numër më të madh të muslimanëve në vitin 2030 se sa në ndonjë vend tjetër evropian, përveç Rusisë dhe Francës.

Llogaritjet e Pew-it demonstrojnë se frika nga një pushtim ose marrje muslimane e Evropës në shkallë të gjerë është produkt i histerisë. Franca nuk është e destinuar të bëhet një "republikë islamike" në 2048 siç pretendojnë disa.

Fatkeqësisht, këto rezultate dhe projeksione të qendrës për statistika Pew nuk po qarkullojnë aq gjerësisht dhe aq shpejt sa po qarkullojnë statistikat dhe parashikimet e tjera për një pushtim musliman, duke ngjallur kështu një frikë të gabuar.



Rezultati i tërë kësaj është se në Amerikë, kombi i emigrantëve është ai – duke u bazuar në Pew, Gallup dhe të tjerët – të cilin afërsisht gjyma e amerikanëve e shohin Islamin si fe të dhunës. Për pasojë, shumë vende evropiane me traditë të gjatë të tolerancës, si Mbretëria e Bashkuar dhe Holanda, në tërheqje ose "vetëmbrojtje", po u japin pushtet partive të krahut të djathtë që kanë politika anti-emigrante dhe anti-muslimane. Emigracioni dhe larushia kulturore janë dy pika të forta që ata i ndjekin dhe në këto dy aspekte ata nuk lëshojnë pe. ■

John L. Esposito, autor i librit "E ardhmja e Islamit" është profesor universitar i religjionit dhe marrëdhënieve ndërkombëtare në universitetin Georgetown. Sheila B. Lalwani është hulumtuese.

Revista Paqja ka lejen e posaçme për të botuar këtë artikull.

Përktheu:
Osman D. GASHI



MIDIS AUTORITARIZMIT DHE ISLAMIT

Arsim JONUZI

Mundësitë për një ndryshim të thellë në Lindjen e Mesme kanë filluar të zbehen. Në muajt e fundit, Afrika Veriore dhe Lindja e Mesme kanë qenë të tronditura nga erërat e të ashtuquajturës "pranverë arabe". Tani, disa muaj që nga rënia e Mubarakut, duket të jetë një kthim në normalitet, ose ndoshta një normalizim: referendumi për një kushtetutë të re nuk ka ndryshuar shumë në letër, ushtria ka ndaluar demonstratat publike, Vëllazëria Muslimane është bërë më e sigurt ... Edhe Tunizia ka të njëjtën vështirësi në gjetjen e një mënyre të qeverisjes që nuk është e njollosur nga korrupsioni i së kaluarës dhe, ndërkohë, në Libi është duke u zhvilluar një luftë, e cila ka përfshirë edhe Perëndimin.

Në Egjipt, partitë që janë të organizuara janë vetëm ato të Mubarakut dhe të Vëllazërisë Muslimane. Ata ia dhanë votën dhjetë pikave të referendumit, nisën një kushtetute të re dhe caktuan zgjedhjet e reja për muajin shtator 2011. Vendi nuk mund të mbetet shumë kohë pa një kushtetutë të re dhe zgjedhje të lira. Rritja e fuqizimit politik të Islamit është real. Sipas një video në internet, në qoftë se sekularizmi arrin në Egjipt, nga viti në vit, vendi do të jetë i "përmbytur" nga vala e imoralitetit perëndimor si: pirja e alkoolit, droga, martesa mes homoseksualëve, etj ... dhe të gjitha këto, Vëllazëria Muslimane i lidh me sekularizmin. Është krejtësisht normale që pas disa muajve, njerëzit e turbulluar duan të kthehen në normalitetin e tyre të përditshëm: rihapja e shkollave në mënyrë që studentët të mos humbasin asnjë vit akademik; rikthimi në punë për të nxitur një ekonomi që është ende në krizë. Qëndrimi i ushtrisë ishte normal dhe i parashikueshëm: "Ne do t'ju mbështesim - thonë ata - por tani vendi nuk mund të përballojë një dështim nga pikëpamja ekonomike. Pala që bëri revolucionin nuk e di se cilën rrugë të ndjekë. Ata s'mund të gjejnë një udhëheqës të aftë për të qenë një forcë shtytëse. E ardhmja është e panjohur.

Në Tunizi, nga një pikëpamje, gjërat janë në rregull. Partia Islamike Ennahdha, e themeluar nga Rachid Ghannouchi, e cila u ndalua në viti 1991, u pranua më 1 mars 2011. Me partinë Ettahrir të paautorizuar, ata janë duke u përpjekur për të hequr sekularizmin. Akti i parë që kërkuan ishte që gratë të lejohen të fotografohen me mbulesë për dokumentet e identitetit. Kjo ishte e ndaluar më parë. Më 2 prill, kjo "e drejtë" u votua. Shumë tunizianë i japin prioritet përkatësisë islame dhe disa të rinj refuzojnë "laiciz-



min". Disa e duan sekularizmin. Por shumica e tyre e shohin këtë çështje përmes syve të emigrantëve në Francë, që jetojnë në një vend laik, ku kufizohen festimet muslimane, ndalohen vellot, dhe ku lejohet "imoraliteti"...

Në Siri, pavarësisht trazirave në të, ndoshta asgjë nuk do të ndryshojë. Thuhet se peshkopët e krishterë nuk duan asgjë për të ndryshuar pasi është autorizimi i regjimit të Asad-it që ndalon përhapjen e Islamit, ruan sigurinë dhe sekularizmim. Ata që kundërshtojnë Assad-in nuk janë minoritetet ose të krishterët, të cilët i frikësohen rritjes së një regjimi suni, por ata që e luftojnë (të cilët janë shumë), janë armiq të Assad-it, të cilët ndihen të përjashtuar nga pushteti dhe Vëllazëria Muslimane, e cila kanë qenë e shtypur për dekada të tëra. 'Ne jemi të zënë vazhdimisht ndërmjet dy të kundërtave: demokraci me sekularizëm ose Islam. Ne të krishterët i duam të dyja, demokracinë dhe sekularizmin, por në praktikë, tani në Lindjen e Mesme nuk janë në gjendje të afirmohen së bashku', - citohet të ketë deklaruar një prift në anonimitet. Prandaj në fund të fundit, të krishterët preferojnë të kenë një regjim autoritar, por një që u garanton atyre të paktën një minimum të lirisë fetare. Kjo është drama e Lindjes së Mesme. Në Evropë, sekularizmi dhe demokracia bashkëjetojnë, ndërsa në Lindjen e Mesme ato nuk pajtohen.

Përballë kësaj gjendjeje, është e rëndësishme që të përmendet shembulli i Libanit, ku ka edhe demokraci edhe sekularizëm, respekt ndërfetar, krejtësisht të ndryshëm nga sekularizmi perëndimor. Më 2 prill Myftiu suni, Mohammed Rashid Kabbani, shkoi në Bkerke, shtëpia e Patriarkut Maronit që nga viti 1823, për të takuar Patriarkun Maronit, Rahi Bechara-n. Myftiu i propozoi një takim të madh islamik - e krishterë, që do të mbahet së shpejti në Bkerke, "sepse Bkerke - tha ai - është selia kombëtare dhe shpirtërore rreth të cilit bashkohen të gjithë libanezët, të krishterë e myslimanë". Për shkak se Libani është ende pa një qeveri, Myftiu mendon se në këtë mënyrë ata mund të forcojnë "bashkësinë shpirtërore dhe sociale për të rindërtuar strukturën sociale". Në mesin e shteteve ku situata është e qetë, bën pjesë Jordania, ku në saje të mbretit, ka një ekuilibër të caktuar. Në Egjipt ka shumë njerëz të cilët duan të jetojnë së bashku dhe mbajnë demonstrata me kryq dhe Kuran.

Problemi është se populli arab e ka të vështirë të adaptohet në demokraci. Ekziston droja se ata mund të kalojnë nëpër luftëra civile në një tranzicion të gjatë demokratik me konflikte të brendshme të theksuara të natyrës si në Irak (Jemen etj). Zërat muslimanë që mbrojnë demokracinë dhe neutralitetit fetar janë ende në frekuencën e pëshpëritjes. Të rrallë janë sidomos zërat e imamëve që përkrahin ndarjen e xhamisë nga politika, fesë nga shtetit. Rrjedhimisht faza tranzitore që do të përshkojë vendet arabe do të luhatet në mes autoritarizmit dhe Islamit, me pak elemente demokratike. ■



ASTMA BRONKIALE

Prim. dr. med. sc. Ali ILJAZI
Internist - pulmolog

Astma bronkiale është sëmundje kronike obstruktive e rrugëve të frymëmarrjes, e cila shkakton probleme serioze gjatë frymëmarrjes.

Karakterizohet me një reaksion të fuqishëm imunologjik dhe inflamacion kronik të sistemit trakeobronkial.

Sëmundja paraqitet në episode, d.m.th. përkeqësimet akute të sëmundjes ndërrohen në periudhat në të cilat nuk ka simptoma të astmës. Deri te sulmi astmatik arrihet gjatë përkeqësimit të inflamacionit, zakonisht ngase në mjedisin përkatës është prezent një faktor irritues, ose një faktor provokues i astmës.

Çfarë e shkakton astmën?

Trashëgimia mund të luajë një rol të caktuar, por ekzistimi i astmës në familje nuk do të thotë se definitivisht ju ose fëmija juaj do të sëmuret nga astma.

Trashëgohet afiniteti ndaj sëmundjes, e jo vetë sëmundja!

Astma shpesh paraqitet, për herë të parë, në fëmijëri dhe përfshin më tepër meshkujt se femrat.

Atopia dhe /ose alergjitë në familje janë faktorët më të mëdhenj të rrezikut për zhvillimin e sëmundjes te fëmijët. Atopia është afinitet i sistemit imunitar për të prodhuar antitrupa nga agjentët e rëndomtë, që shkakton simptoma të alergjisë.

Dermatiti atopik (ekzema) dhe riniti alergjik mund të shërbejnë si tregues kryesorë të rrezikut të astmës te të porsalindurit dhe fëmijët e vegjël.

Si shkaktohet astma?

Nuk janë të gjitha format e astmës alergjike dhe as të gjitha alergjitë nuk shkaktojnë astmën bronkiale.

Astma paraqitet në mënyra të ndryshme. Mirëpo mekanizmi themelor, i cili sjell deri te simptomat e astmës, është një reaksion imunologjik i komplikuar i sistemit tonë respirator në alergjene të ndryshme nga mjedisi i afërt (më së shpeshti dermatofagoides, poleni dhe pluhuri), me ç'rast zhvillohet reaksioni inflamator, duke u liruar mediatorët kimik të inflamimit.

Klasifikimi i astmës

1. Astma alergjike

Faktorët provokues janë:
- Furrtarja e zezë - Dermatofagoides pteronyssinus (alergjeni kryesor në pluhurin e shtëpisë).
- Qimet, puplat dhe epiteti i kafshëve.
- Kërpudhat.
- Poleni i barit, drunjve dhe shkurreve.

2. Astma joalergjike

Faktorët provokues janë:
- Tymi i cigareve.
- Mjetet dezinfektuese në amvisëri.
- Parfumet dhe aromat.
- Faktorët e ndotjes së mjedisit.

3. Astma profesionale

Alergjenët dhe faktorët provokues janë:
- Faktorët të cilët përshpejtojnë zhvillimin e astmës duke përfshirë ekspozimin e avujve, kimikateve, pluhurit, pesticideve, tymit dhe substancave tjera nga vendi i punës.

4. Astma e ndikuar nga aktiviteti fizik

Alergjenët dhe faktorët provokues janë:
- Ushtrimet që përfshijnë thithjen e ajrit të ftohtë (vrapimi gjatë dimrit) mund të shkaktojnë astmën e ndikuar nga aktiviteti fizik.

5. Astma e ndikuar nga aspirina

Një numër i konsideruar i njerëzve është i tejndjeshëm ndaj ilaçeve josteroide inflamatore, konservuesëve dhe emulgatorëve të ndryshëm në ushqim.

Simptomat e astmës

Pas ekspozimit të alergjenëve ose faktorëve të rrezikut, simptomat paraqiten vrullshëm menjëherë, ose rrallë pas disa orëve ose ditëve.

Simptomat klasike të sulmit astmatik janë: kollitja spazmodike, frymëzërja, fishkëllim gjoksi dhe ekspirium i zgjatur. Para sulmit astmatik mund të shkohet deri te irritimi i hundës dhe grykës. Sulmi zakonisht fillon me fishkëllim, dispne dhe përshpejtim të frymëmarrjes. Të gjithë muskujt e frymëmarrjes aktivizohen, kështu që të folurit përkeqësohet. Fundi i sulmit shënohet me sputum të dendur.

Astma, zakonisht, përkeqësohet natën, ndërsa sulmet paraqiten në mes orës 2 dhe 4 të mëngjesit.

Si parandalohet astma apo përkeqësimi i sëmundjes?

Astma mund të parandalohet. Te fëmijët, në familjet e të cilëve është regjistruar astma ose atopia, fillimi i zhvillimit të astmës padyshim mund të parandalohet me largimin e ekspozimit të pirjes pasive të duhanit, pluhurit të shtëpisë, alergjenëve në ushqim, polenit, si dhe alergjenëve nga macet dhe kafshët e tjera. Qasja e re në terapinë e astmës ndihmon të sëmurët t'i parandalojnë shumicën e sulmeve, zgjidhjen e simptomave problematike gjatë natës dhe ditës, duke mbetur fizikisht aktivë. Për të arritur një kontroll adekuat të astmës nevojitet:
- Zgjedhja e ilaçeve adekuate dhe dozimi individual,
- qasja afatgjatë në kurimin e astmës,
- shërimi i sulmeve akute të astmës,
- identifikimi dhe mënjanimi i faktorëve që përkeqësojnë astmën,
- përcjellja dhe adaptimi i terapisë sipas shkallëzimit të simptomave të astmës,
- konsultimi i përhershëm me mjekun,
- hiposensibilizimi,
- edukimi i prindërve në lidhje me sëmundjen e fëmijës,
- kinezoterapia respiratore,
- aplikimi i metodave të diagnostifikimit të hershëm të sëmundjes: ekzaminimi funksional i sistemit respirator (spirometria, bodi pletismografia), testet alergjike kutane dhe bronkoprovokuese, IgE, etj. ■

“PIKA në TRU” sëmundje dramatike me pasoja fatale

E paraqitur si një sëmundje dramatike “Pika në tru” mund t`i godasë të gjithë, madje edhe të rinjtë, duke u bërë faktori më i shpeshtë i invaliditetit të parakohshëm. Edhe përkundër rrezikshmërisë së lartë nga kjo sëmundje, përmes masave paraprake më të mira, përmes njohjes më të sigurt të shenjave paralajmëruese dhe veprimit të shpejtë dhe të duhur në rast rreziku, do të mund të shmangeshin komplikimet që mund të shkaktojë kjo sëmundje


Artan BEJTA &Jehona SAHITI

Çka paraqet pika në tru?

Truri është organi që ka nevojë më së tepërmi për energji të plotë, e po ashtu organi që më së paku ka mundësi për akumulimin e kësaj energjie. Për këtë, dy elementet kryesore bazë për të funksionuar si duhet truri janë oksigjeni i mjaftueshëm dhe sheqeri, të cilat arrijnë deri tek ai përmes gjakut që i përcillet trurit nga zemra. Edhe pse, po ta krahasojmë me pjesët e tjera të trupit, truri është një organ i vogël, ky organ megjithatë ka nevojë pothuajse për ¼ të sasisë së përgjithshme të gjakut që i përcillet pasivisht nga zemra.

Mekanizmi bazë që paraqitet gjatë “Pikës në tru” ngërthen në vete pengesat në qarkullimin e gjakut në pjesë të caktuara të truri, e si pasojë e këtij edhe mosmundësia e trurit që të ushqehet me dy elementet bazë të tij (oksigjenin dhe glukozën). Qelizat nervore në pjesën e goditur të trurit marrin pak ose aspak oksigjen dhe glukozë kështu që ato do të dëmtohen dhe nëse furnizimi me gjak nuk rikthehet brenda pak minutash ato (qelizat nervore) dëmtohen në tërësi dhe në mënyrë të pakthyeshme.


> Me rëndësi është që të bëni matjen e shtypjes së gjakut, ashtu që të jeni në dijeni për nivelin e shtypjes së gjakut, ngase shtypja e lartë e gjakut nuk vërehet vetvetiu.
> Nëse konstatohet shtypja e lartë e gjakut, atëherë ajo duhet mjekuar, por nganjëherë hipertenioni mund të normalizohet qoftë edhe vetëm përmes dobësimit fizik (humbjes së qëllimshme të mbipeshës). Te disa njerëz mjafton edhe reduktimi i kripës së kuzhinës (kripa mund të zëvendësohet shumë herë përmes erëzave, respektivisht barishteve të ndryshme) dhe mos pirjes së alkoolit.
> Në shtypjen e gjakut ndikojnë pozitivisht gjithsesi edhe lëvizjet e trupit (ecja në natyrë) dhe çastet e shtensionimit. Këto masa, megjithatë, nuk janë përherë të mjaftueshme. Në raste të këtilla përdorimi i medikamenteve që ndikojnë në uljen e shtypjes së gjakut, me qëllim të rikthimit të saj në vlerat e normales, është e pashmangshme.



Se cilat funksione të trupit dëmtohen pas goditjes në tru dhe sa të rënda janë pasojat varet prej vëllimit dhe gjendjes së pjesës së prekur nga ky çrregullim. Meqë qelizat e trurit nuk mund të ripërtërihen, shumë pacientë, pothuajse çdo i katërti, pas goditjes në tru mbeten invalidë të shkallës së rëndë (i hendikepuar) dhe nuk janë më në gjendje të kenë jetë të pavarur.

Faktorët e rrezikut

Arterioskleroza - Arterioskleroza është arsyeja më e shpeshtë e pengesave në qarkullimin e gjakut. Si një proces tinëzar, arterioskleroza vepron me vite të tëra derisa të shkaktojë problematika të mëdha, shpesh edhe të paevitueshme. Procesi i formimit të arteriosklerozës është i nxitur nga faktorë të shumtë. Si rezultat i deponimit të yndyrave në gjak, të cilat pastaj përmes rritjes së qelizave në gjak, respektivisht ngushtimit të enëve të gjakut dhe qelizave muskulore në shndërrim në të ashtuquajturën “pllakë arteriosklerotike”, arrihet deri te ngushtimi i enëve të gjakut dhe pengesave në qarkullimin e gjakut. Nëse gjatë qarkullimit gjaku has në pengesa, atëherë kjo shkakton ndërprerjen e plotë të furnizimit të trurit me gjak, në këtë rast edhe me elementet bazë për funksionimin e tij (oksigjenin dhe sheqerin glukozë). Në rast se enët e gjakut të tru-



rit pësojnë një patologji të tillë atëherë rreziku i paraqitjes së "pikës në tru" është i madh.

Shtypja e lartë e gjakut - Hipertensioni është faktori më i rëndësishëm që shkakton pikën në tru. Në rast se muret arteriale, përmes shtypjes së gjakut, i nënshtrohen në vazhdimësi një lloj trysnie të theksuar, ato sforcohen dhe trashen. Substancat yndyrore sedimentohen dhe me këtë rast arterioskleroza merr rrugë. Përpos kësaj mund të ndodhë që pjesa e brendshme e arterieve të lëndohet ose ndonjë enë gjaku nën trysnin e gjakut pëlcet dhe kështu shkakton gjakderdhjen.

Sëmundja e sheqerit - Sëmundja e sheqerit (Diabetes mellitus) shkaktohet nga mungesa ose nga çrregullimi i hormonit të insulinës. Trupi ka nevojë për insulinë me qëllim që sheqeri (glukoza) të kalojë nga gjaku në qelizat e trupit. Në fakt ajo (insulina) është çelësi që bën bartjen e glukozës në qeliza. Në rast se kemi mungesë të insulinës, pason ndjeshëm ngritja e sheqerit në gjak. Edhe pengesat në vlerat e insulinës shpien pashmangshëm në dëmtimin e enëve të gjakut dhe në krijimin e pengesa në procesin e shndërrimit të yndyrave.

Sëmundja e zemrës - Sëmundjet e zemrës (Angina pectoris, infarkti i miokardit) e po ashtu pengesat në ritmin e rregullt të zemrës, pasohen me rritje të faktorit rrezikues për përjetimin e pikës në tru.

Pas tri deri pesë vjetësh, varësisht nga numri i cigareve që keni pirë më herët, rreziku i përjetimit të pikës në tru reduktohet në nivelin e normales, si tek ata që nuk kanë pirë fare duhan!

Pirja e duhanit - Dihet mirë se pirja e duhanit nuk është vetëm faktor që rrezikon paraqitjen e kancerit, por ndikon ndjeshëm edhe në dëmtimin e enëve të gjakut. Materiet e dëmshme që merren përmes tymit zvogëlojnë furnizimin e organeve dhe mureve të enëve të gjakut me oksigjen. Ato sforcohen dhe ngushtohen dhe kështu krijon parakushte për të ndihmuar paraqitjen e arteriosklerozës, e cila siç kemi cekur më lart kjo ndikon në sedimentimin, me çka pason rritja e shtypjes së gjakut.

Mbipesha - Mbipesha ngarkon dhe pengon procesin normal të qarkullimit të gjakut dhe ngrit shtypjen e gjakut. Vetëm duke ulur peshën mund të ulni ndjeshëm shtypjen e gjakut. Në këtë rast sasia e yndyrës në gjak reagon pozitivisht (duke u ulur).

Vlera e ngritur e yndyrave - Sasia e tepërt (e lartë) e yndyrës në gjak (Hiperlipidemi ose Hiperkolesterinemi) luan rol të madh në paraqitjen e arteriosklerozës. Në rast se vlera e yndyrave në gjak është e lartë. Për ta ulur atë do të ndihmonte ndryshimi rrënjësor i ushqimit. Në këtë rast vëmendje duhet kushtuar në reduktimin e marrjes së yndyrave me prejardhje shtazore (sallame të ndryshme, mish, gjalpë, kajmak) dhe konsumit nga materiet ushqyese, të ashtuquajturat ushqim i pangopur me yndyrë (si p.sh. vaj ulliri, luledielli, bimësh etj). Nëse nuk ia arrini të riktheni vlerën e yndyrës në gjak në nivelin e dëshirueshëm, atëherë mjeku, duke marr parasysh faktorët rrezikues, do t`ju udhëzojë marrjen e medikamentit përkatës, që do të ulte këtë vlerë në nivelin e duhur.

Lëvizja e mangët - Lëvizjet e rregullta, pra aktiviteti i rregullt fizik tashmë është dëshmuar se është njëri prej faktorëve që ndikon në uljen e rrezikut nga shumë sëmundje (sëmundjet koronare të zemrës, nga diabeti i tipit II melitus, nga kanceri në zorrë të trashë dhe nga osteoporoza, etj.) të cilat lidhen direkt me rrezikun e paraqitjes së "pikës në tru".

Alkooli - Rreziku në përdorimin e alkoolit në paraqitjen e "pikës në tru" qëndron në atë se alkooli është faktor rreziku për paraqitjen e shtypjes së lartë të gjakut, e cila fajësohet direkt si faktor madhor në paraqitjen e "pikës në tru".

Stresi - Stresi shpreh rënien e gatishmërisë së trupit për aksione, rrit shtypjen e gjakut dhe frekuencën e të

Çdo ditë, së paku 30 minuta, lëvizje me intensitet të mesëm (kjo kohë bën edhe të ndahet 3 herë nga 10 minuta), të cilat do të kishin ndikim dobiprurës për shëndetin tuaj.



rrahurave të zemrës. Sot është tashmë e verifikuar se situatat me stres si p.sh. gjendja e pakënaqur në punë, kufizimi i lirisë personale dhe vështirësitë e tjera sociale, paraqesin vetvetiu faktorin rrezikues për sëmundjet e enëve të gjakut.

Sinjalet serioze të paralajmërimit të pikës në tru

Te shumë raste të pikës në tru paraprakisht paraqiten sinjalet paralajmërues. Sinjalet e tilla paraqiten si "pika të vogla" dhe konsiderohen si sulm kalues (atak iskemik, sulme kalues përmes gjakderdhjes së brendshme). Shkaktarë të lajmëtarëve të tillë është pengesa në njëfarë mase e qarkullimit të gjakut në arteriet e trurit si pasojë e sedimentimit të gjakut në një nga ato arterie. Ky sedimentim zvogëlon përkohësisht furnizimin me gjak. Ataku ishemik kalues mund të paraqitet përmes simptomave pasuese, të cilët pas pak minutash përsëri zhduken. Si simptoma paralajmëruese janë:

- Pengesa të çastit në perceptim, ndjenja ose paraliza e njërit krah, njërës dorë ose njërës këmbë;
- Pengesa të përkohshme në të folur;
- Pengesa të përkohshme në shikim (si shikimi i dyfishuar ose verbim i shkurtër i njërit sy);
- Marramendje;

Nëse ju vëreni shenja të tilla te vetja juaj ose personi i afërm i juaji, do të duhej të njëjtën ditë (më së miri) ose më së largu ditën pasuese të paraqiteni te mjeku në mënyrë që ta parandaloni "pikën në tru".

Simptomat (shenjat) e pikës në tru

Në rast se vjen deri te pika në tru pa asnjë shenjë paraprake, atëherë nuk kemi një parafytyrim, pamje unike të sëmundjes. Megjithatë simptomat e mëposhtme mund të thuhet se janë më tipiket për "pikën në tru":

- Paraliza (e pjesshme) - Dobësimi i çastit, respektivisht paraliza e çastit më së shumti vetëm në njërën pjesë të trupit (fytyrë, krah ose këmbë);
- Pengesat në të parë - Verbimi i çastit, pengesat në të parë nga njëri sy, pra në të majtin ose në të djathtin ose të dy sytë, madje në pamje të dyfishtë;
- Pengesat në të folur - Humbja e çastit e të folurit ose vështirësitë në të folur, vështirësia në të kuptuar;
- Marramendja - Marramendja në kohë më të gjatë, pasiguria në të ecur;
- Dhimbjet e kokës - Dhimbja është e çastit, dhimbje të pazakonta dhe të forta.

Në rast paraqitjeje të këtyre simptomave vizita te mjeku është më se e domosdoshme dhe urgjente. Gjithsesi edhe atëherë kur i prekuri shenjat nuk i merr me seriozitet dhe gjendjen nuk e gjykon drejt e si duhet. ■



Kush dëshiron të humbasë peshë dhe ta mbajë atë në nivel të ulët do të duhet të respektojë masat e kombinuara: në njërën anë të kontrollojë marrjen e ushqimeve kalorike, por në anën tjetër edhe të lëvizë sa më shumë. Të ushqyerit me ushqim që përmban sa më pak kalori, d.m.th. marrje e ushqimit që ka sa më pak yndyra, por ushqim të llojllojshëm, që orientohet në piramidën e ushqimit. Dietat e shpejta dhe radikale, në fakt, sjellin deri te humbja e peshës në rrugë të përshpejtuar, por pothuajse kurrë nuk shpien në rezultate afatgjate.

Veçoritë e një shkrimtari postmodern

SHKRIMTARI POSTMODERN

Kur flasim për letërsinë postmoderne, ose për një autor të veçantë të saj, çdo njeri që përpiqet t'i njohë gjërat do të pyeste: Ç'është një shkrimtar postmodern, çka e bën atë të jetë postmodern? Çfarë estetike i përmbahet ai, nëse i përmbahet ndonjë estetike?

Adil OLLURI

Juri Lotman në veprën e tij "Kultura dhe bumi" thekson se ndryshimet kulturore ndodhin për dy faktorë: *së pari, si zhvillim imanent, së dyti, si rezultat i ndikimeve të jashtme të llojllojshme.* Nga këta dy faktorë, gjithsesi, ka ndodhur edhe ndryshimi drejt një diskursi specifik të letërsisë postmoderne, e cila është *një etapë e veprimtarisë estetiko-artistike, një fushë globale intelektuale e kulturore, që tërheq në vakuumin e idealit estetik nostalgjinë lodërtare (nostalgjinë e lojës) e ironike.*

Kur flasim për letërsinë postmoderne, ose për një autor të veçantë të saj, çdo njeri që përpiqet t'i njohë gjërat do të pyeste: Ç'është një shkrimtar postmodern, çka e bën atë të jetë postmodern? Çfarë estetike i përmbahet ai, nëse i përmbahet ndonjë estetike, apo edhe çfarë ideologjie shpreh vepra postmoderne? Këto janë çështje që ngrihen para çdo lexuesi, kritiku a studiuesi, që dëshiron ta hulumtojë këtë tip letërsie.

Shkrimtari postmodern është në pozitën e mbledhësit të literaturës, siç është ta zëmë prokurori në pozitën e mbledhësit të fakteve, nëse na lejohet të bëjmë një analogji të tillë. Ai jo vetëm që e mbledh, por edhe e ripërpunon dhe e shfrytëzon jashtëzakonisht shumë materialin kulturor, literaturën, si në mënyrë implicite të shfrytëzimit, ashtu edhe në mënyrë eksplicite në formë citatesh, duke krijuar kështu fenomenin e citatësisë në tekstet postmoderne. Në këtë aspekt, theksohet se *citati është element konstituiv i letërsisë postmoderne, dhe sipas tij citatësia paraqet një nga format më eksplicite të intertekstualitetit.* Përdorimi i citatit në një vepër postmoderne, duke krijuar kështu një korpus citatesh brenda saj, i japin kësaj vepre një nuancë eruditive, shkencorizuese, sepse një shkrimtar postmodern mund ta përdorë, ta zëmë një citat nga *"Lahuta..."* e Fishtës, a nga romanet e Sabatos, ashtu siç mund ta përdorim ne në një punim disertacioni. Kjo nuancë eruditive si duket e bën veprën postmoderne një tërësi enciklopedike.

Jo vetëm përdorimi, por edhe shfrytëzimi i lirë i citatit, materialit kulturor, është element bazik i kësaj letërsie, e cila shfrytëzon, siç thotë populli, pa teklif, traditën e mëhershme kulturore, ku këto citate marrin edhe konotacione të reja në veprën e re. Madje duke rënë në kurthin e rrjetit postmodern, ato ndoshta edhe mund ta humbasin krejtësisht semantikën e tyre të parë. Këto citate të shfrytëzuara nga shkrimtari postmodern kombinohen në tekstin e tij, për të krijuar kështu një *art që ndërtohet përmes teknikës së kombinimit*. E kur jemi te kombinimi i citateve, atëherë doemos jemi në domenin e zhvillimit intertekstual, në domenin e referencave, të cilat zhvillohen jo në relacion me një *tekst*, por me *tekstet*, dhe këto relacione zhvillohen jo për ta krijuar *idenë*, por për t'i krijuar *idetë*. Pra, kjo është rruga që ndjek shkrimtari postmodern, i cili duke krijuar një kombinatorikë të citateve dhe një kompleks intertekstual, normalisht se kryen një proces eklektik (përzierjen e diskurseve, zhanreve etj).

Nëse flasim për domenin estetik të kësaj letërsie, atëherë do të duhej të pyesnim se a ekziston me të vërtetë një estetikë, një kanon, sipas së cilit do të mund ta vlerësonim një vepër a është a s'është postmoderne. Lidhur me këtë pikë, do t'i kthehemi e ta parafrazojmë Ihab Hasanin, kur flet për *rregullin e gjendjes së çrregullt në mendimin postmodern*. Këtu duhet të kemi parasysh se Ihab Hasani nuk flet as për estetikë, as për letërsi, por mendimin e tij mbi shoqërinë dhe kohën postmoderne po e adaptojmë me qëllim operimi, që ta shpjegojmë estetikën. Pra, estetika postmoderne është *estetikë e rregullit të çrregullt*. Dhe sa më i çrregullt të jetë rendi i saj, aq më postmoderne është vepra. Formën letrare postmoderne e karakterizon paradoksi, ironia, parodia etj. Në këtë aspekt, Linda Haçion thotë se *diskurset postmoderne janë thelbësisht*



kundërthënëse, paradoksale, duke sugjeruar edhe një estetikë të tillë. Ndërsa, Umberto Eko e thekson *ironinë intertekstuale* si element thelbësor të kësaj letërsie, duke sugjeruar (jo duke thënë) *edhe një estetikë, bosht i së cilës do të ishte ironia intertekstuale*.

Ironia intertekstuale nënkupton lojën fiksionale, lojën me vërtetësinë, lojën me kohën, me kodet elitiste dhe popullore të komunikimt dhe ironizimin e traditës.

Nga kjo rrjedh edhe ideologjia e postmodernizmit. Por, këtu duhet të kemi parasysh se fjala ideologji nuk e ka atë konotacionin negativ me të cilin jemi mësuar ta përdorim, por është një *logos*, sistem i ideve që gjenden brenda postmodernes, ose brenda lexuesit, siç thotë Eko në një rast. *Ideologji e postmodernes është rivlerësimi i së kaluarës, traditës në mënyrë ironike, parodizuese e paradoksale*. Dhe këtu duhet ta kemi parasysh që postmodernia nuk e mohon të kaluarën, por vetëm e konteston atë. Ajo jeton në të kaluarën, për dallim prej modernes që jeton në të tashmen dhe e synon të ardhmen. Ajo, në kontekst, është cilësuar si një lindje e re, *me qëllim që të shënojë diçka të re, të kohës, një ecje me kohën, njëkohësisht për ta dalluar kohën e modernes prej diçkaje që duhet të jetë më bashkëkohore, që i përshtatet të gjitha gjinive, moshave e kulturave.* ■



50-VJET MORAL ARTISTIK

Naser SHATROLLI

Figura në formë rojesh mbretërore. Roje që thonë diçka përreth dhe mbi fortesa historike. Grabuja me gjemba, fshesa e dorës e shufruar, e cila fshin mërzi, dhembje, ndriçon sy me sytë e saj në formë zjarri. Hunda e gjatë që fortifikon qëndresë, që identifikon në përmbajtje shpirt për njeriun. Hundë nuhatëse, që filtron art dhe ajër për tokën e tij. Ngjyra e mbylltë që i ngjan lëkurës dhe fytyrës së çuditshme të tij. Ai e ndërton konceptin artistik aq thjesht dhe të kthen besnikërisht në vitet e 50-ta. Kjo mënyrë loje, do të nominohej si kinematografi historike në pëlhurë. Pra, loja e tij ishte e ndërtuar filmikisht. Fabulat janë të ndërtuara me dorë të lirë. Ta çojnë mallin e klasës së parë fillore, kur fëmija e nis vizatimin, kur përdor lapsin dhe gomën dhe fillon t'i dallojë ngjyrat. Ky krijues, vërtet i ngjason fëmijës, sepse është shumë i besueshëm dhe origjinal karshi punës së tij. Fëmija nuk gënjen. Ai e dashuron botën ashtu si është. Është "fëmijë" dhe vizaton lirshëm edhe kur nuk ka liri. Nuk përdor gomë edhe kur gabon, sepse gabimi për të është një e vërtetë historike për artin e tij, për tematikat e tij njerëzore e historike. Secila tabelë, ka bukë thekre të arës së vet. Dhe ne patëm mundësi që t'ia ndjenim erën asaj buke, kaq origjinale, të ngjeshur dhe të pjekur mirë e arsyeshëm.

I mbyllur në pëlhurat e viteve

Krijimtaria është lojë e vërtetë. Loja luhet për të ndërtuar kala nëpër kohë, fundja, secili punim i tij, ka këtë vizion, ka këtë kompleks jete në bazament. Kohën e kuptojmë që ka shkuar dhe si ka qenë duke e parë ikonografinë artistike të këtij njeriu, imazh dheu. Dhe në fund, thua, a ishte njëmend kjo lojë për ne, apo lojë për vetveten. Ai ka masë në lojën e tij, dominon imagjinata. Fabulat i ndërton në binarët e ecjes. Asgjë më shumë sesa përrallë është jeta që kapërcejmë. Shumë fytyra të frikshme, flokët formë shufrash metali, detaje që do ta njomin flokun e thatë të kohës së sotme.

Kjo krijimtari e Salihamxhiqit është mituri Lasgushjane. Vetëm këtu dhe askund tjetër nuk sheh dashuri "naive", të brishtë, mbi 50 vite moral artistik. Jeta është si goma. Kur duam e fshijmë atë. Ky vjen si mesazh i gjithë asaj krijimtarie filmike e tipit të Pikasos, ose Karavaxhos. Pra, pëlhura e tij do të mund të shfrytëzohet në ekran për filmbërësin, përderisa jetën e të rriturit dhe të rriturin e mituron, e bën fëmijë pa kusure. Kështu duket edhe ai vetë, artist që ushqehet me ilaçe, që pi cigare dhe nuk ja ka frikën tymit të saj.

Njeri që, me lot në sy, i thotë Fahredin Spahisë, drejtorit të Galerisë së Arteve, të jam mirënjohës përgjithmonë. Kjo tingëllon dhembje, sepse të gjithë krijuesit e kanë një mision. Për ta ushqyer masën me art dhe veten me dhé toke.

Këtë mrekulli artistike ne s'e kemi ditur, as s'e kemi njohur. Kjo ishte premierë për ne. Ai ka jetuar i mbyllur në pëlhurat e tij me vite të tëra. Kjo autobiografi e tij është identitet real për ngjyrat njerëzore të popullit dhe vendit të tij që reflektojnë një postmoderne përkarshi ngjyrave globale. ■

POEZI

Izet AVDYLI

IME MIKE

Moti s'jemi parë
Me dekada vite
U shfaqe si në legjenda
E mira, ime mike

Folëm nga distanca
E shprushëm kujtime
Sa më kish marr malli
E mira, ime mike

SA HERË BIE BORË

Sa herë bie borë
Në mua ngjall kujtime
Shfaqet portreti yt
Në dritaren time

Bien fjolla bore
Hidhem në meditime
Si dikur në rini
Yll i jetës sime

Sa herë bie borë
Tretem në mendime
Imazhi i fytyrës sate
Shfaqet n' dritaren time

Tash në kokat tona
Ka rënë borë e bardhë
Mbetën veç kujtimet
Për kohën e artë

TA DISH

Ta dish
një lot në syrin tënd
një plagë në zemrën time

ta dish
të dua të fort
të dua trime

PARA SE TË NISË NDESHJA, LEXON KURAN

"UNË GJITHMONË LEXOJ KURAN PARA SE TË DAL NË FUSHËN E LOJËS. LUTEM PËR VETEN, PËR SHOKËT DHE EKIPIN QË ÇDO GJË TË NA SHKOJË MBARË", - ËSHTË SHPREHUR FUTBOLLISTI I KOMBËTARES GJERMANE ME PREJARDHJE TURKE, MESUT OZIL.

Alban BILALLI

Mesut Ozil, ylli i ri Kombëtares së Gjermanisë dhe transferi më i ri i Real Madridit leximin e Kuranit e praktikon jo vetëm në shtëpi, por edhe para fillimit të ndeshjeve në të cilat ai luan. Derisa futbollistët e tjerë bëjnë përgatitjet e fundit fizike para ndeshjes, Ozil ulet dhe lexon Kuran. Ai më pas lutet që Allahu t'i ndihmojë atij gjatë lojës. Ai, po ashtu, lutet edhe për ekipin dhe shokët e tij gjatë ndeshjes. *"Unë gjithmonë lexoj Kuran para se të dal në fushën e lojës. Lutem për veten, për shokët dhe ekipin që çdo gjë të na shkojë mbarë"*, - është shprehur Ozil. Më pas ai ka shtuar se bashkëlojtarët nuk i flasin kur ai kap Kuranin në duar, për të mos e penguar gjatë leximit. *"Kur unë e kam Kuranin në duar dhe lexoj, askush nga shokët nuk më flet"*, - është shprehur Ozil.

Këtë verë ai u transferua te klubi i Real Madridit në Spanjë. Ai aty ka gjetur edhe disa lojtarë të tjerë muslimanë si: Karim Benzema, Mahamadou Diarra, Lassana Diarra, Sami Khedira, të cilët i kanë ndihmuar për t'u ambientuar në kryeqytetin spanjoll. Po në Real Madrid ka luajtur edhe legjenda e futbollit francez Zinedin Zidan, po ashtu musliman, i cili ka lënë gjurmë të pashlyeshme në klubin madrilen. Mediat spanjolle ardhjen e Ozilit në Real e quajtën "Zidani gjerman". Për këtë krahasim nga mediat spanjolle, Ozil u shpreh se ai ndihet i nderuar që krahasohet me një futbollist "të cilin kur isha fëmijë e simpatizoja pa masë".

Karriera prej futbollisti

Mesut Ozil, i lindur më 15 tetor 1988, në Gelsenkirchen, është një futbollist profesionist gjerman me origjinë turke, i cili luan për Real Madridin dhe lojtar kyç i Kombëtares Gjermane të Futbollit. Ozil e nisi karrierën e tij duke luajtur për klube të ndryshme në Gelsenkirchen dhe pesë vjet për Rot-Weiss Essen. Në vitin 2005 ai u transferua në skuadrën e të rinjve të FC Schalke 04. Në 31 Janar 2008, ai u transferua tek Werder Bremen për një shumë prej €4.3 milion, duke nënshkruar një kontratë me klubin gjerman deri më 30 qershor 2011. Përpara se të nënshkruante me Werderin, Ozil kërkohej edhe nga Manchester United. Aktualisht është anëtarë i Real Madrid, klub me të cilin ka kontratë deri në vitin 2016.

Ozil debutoi me Kombëtaren Gjermane gjatë një ndeshjeje miqësore me Norvegjinë në 11 Shkurt 2009. Ozil shënoi golin e parë me skuadrën në paraqitjen e tij të tretë kundër Afrikës së Jugut, në 5 shtator në Leverkusen. Ai u përzgjodh në ekipin kombëtar gjerman për Kupën e Botës të vitit 2010, dhe ishte lojtari më i mirë i Gjermanisë, kurse sot llogaritet si njëri nga lojtarët më të mirë në botë. ■



Intervistë me kryetarin e Federatës së Futbollit të Kosovës, z. Fadil Vokrrin

Ndërkombëtarizimi i futbollit, peng i politikës

Intervistoi: Alban BILALLI



Fadil Vokrri, sot kryetar i Federatës së Futbollit të Kosovës, konsiderohet si njëri nga futbollistët më të mirë të të gjitha kohërave. Pos që i dha shumë futbollit të Kosovës në fushë sa ishte futbollist aktiv, Vokrri është i angazhuar me tërë potencialin e tij që futbollin e Kosovës ta integrojë në organizmat më të lartë të futbollit në botë, në FIFA dhe UEFA. Në intervistën dhënë revistës sonë, Vokrri është shprehur se integrimi i futbollit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare është peng i politikës. Kampionati aktual është më i organizuar se ai i kaluari, kurse për trajnerin e Përfaqësuesës së Kosovës, Albert Bujakun, thotë se po bën punë të mirë. Vokrri është shprehur i kënaqur me përkrahjen që ka nga ministria e sportit dhe shpreson që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe më tutje. Për më shumë flet në intervistën për revistën "Paqja", kryetari i FFK-së, Fadil Vokrri.

PAQJA: ***Kaptina e dytë e edicionit vetëm sa ka filluar, si e vlerësoni atë?***

F. Vokrri: Ne, në Komitetin Ekzekutiv (KE) të FFK-së, vazhdimisht, me kujdes dhe në mënyrë të gjithanshme, bëjmë analizën e rrjedhës së kampionatit. Kështu kemi bërë edhe për këto javët e para të stinorit pranveror dhe mund të themi se kemi një fillim mjaft të mirë. Por ne vazhdimisht kërkojmë nga të gjithë, duke u nisur nga klubet, futbollistët dhe organet që drejtojnë garat, që të shtojnë në vazhdimësi punën dhe angazhimin e tyre në drejtim të rregullshmërisë sa më të mirë të garave. Unë besoj se kampionati do të përfundojë siç është më së miri në këto kushte dhe rrethana në të cilat gjendet futbolli i Kosovës.

PAQJA: ***Vërehen përmirësime në organizimin e ndeshjeve, krahasuar me pjesën e parë të kampionatit?***

F. Vokrri: Shikoni, në krahasim me kampionatet e kaluara është vërejtur një organizim dukshëm më i mirë i ndeshjeve, falë organizimit dhe angazhimit të klubeve, të cilat tashmë e dinë se organizimi është një pjesë shumë e rëndësishme për një lojë dhe një sukses. Kështu që, deri më tash, jemi të kënaqur me këtë organizim, edhe pse aty-këtu mund të ketë ndonjë lëshim, por jo që të rrezikojë rregullshmërinë e ndeshjes.

PAQJA: ***Në çfarë gjendje janë stadiumet? A priten përmirësime në një të ardhme të afërt?***

F. Vokrri: Problemi i infrastrukturës, përkatësisht i stadiumeve, mbetet "thembër e Akilit" për futbollin e Kosovës. Stadiumet ekzistuese ju e dini se pas viteve të 90-ta ishin nën okupimin serb dhe ato veç sa u shkatërruan dhe nuk u punua fare për mirëmbajtjen e tyre. Kjo gjendje e rëndë e trashëguar, fatkeqësisht, po vazhdon edhe sot, për faktin se klubet nuk kanë mundësi materiale për ta përmirësuar, ndërsa shteti i ri i Kosovës po ballafaqohet me nevoja të tjera të shumta. Pastaj, problem në vete është pronësia e padefinuar e këtyre fushave. Në këtë drejtim ne jemi në kërkim të gjetjes së një zgjidhjeje me strukturat e komunës dhe instancat e tjera dhe në një të ardhme të fillohet që stadiumet të përmirësojnë infrastrukturën e tyre, por kjo kërkon angazhimin e të gjithëve: klubeve, qeverive komunale dhe Qeverisë qendrore.

PAQJA: ***Si janë marrëdhëniet ndërmjet klubeve dhe FFK-së?***

F. Vokrri: Klubet janë anëtare të FFK-së dhe ne si "zot të një shtëpie të madhe të futbollit" gjithmonë ndërtojmë marrëdhënie të mira me anëtarët tanë. Vazhdimisht u kemi dalë në ndihmë, për t'ua lehtësuar edhe atyre sado pak gjendjen në të cilën gjenden. Prej



kur unë jam zgjedhur kryetar i FFK-së, klubet nuk paguajnë kotizime, në një kampionat nuk kanë paguar as për persona zyrtarë, sikurse që kemi siguruar një kohë edhe njësitin special të policisë për sigurimin e ndeshjeve. Prandaj, me kaq kujdes të madh ndaj klubeve dhe problemeve të tyre, marrëdhëniet s'ka se si të mos jenë të mira.

Ndërkombëtarizimi, peng i politikës

PAQJA: ***Si po shkojnë punët në pranimin e Kosovës në UEFA dhe FIFA?***

F. Vokrri: Ndërkombëtarizimi dhe integrimi në mekanizmat ndërkombëtarë i futbollit të Kosovës, siç e di gjithë opinioni, ka mbetur peng i politikës. Ne jemi angazhuar maksimalisht dhe po bëjmë çdo gjë që është në fuqinë tonë që kjo të ndodhë. Kemi pasur shumë takime me kreun më të lartë të FIFA-s dhe UEFA-s. Si rezultat i këtij angazhimi, tash Çertifikatat ndërkombëtare të FFK-së njihen nga FIFA dhe klubet tona tashmë janë pjesë e transfereve ndërkombëtare në kuadër të FIFA-s, sikurse edhe klubet nga 205 federata botërore. Ne nuk do të ndalemi, por do të punojmë në këtë drejtim.

PAQJA: ***Në fund të prillit pritet vendimi i UEFA-s pro ose kundër që Kosova të zhvillojë ndeshje miqësore. Sa jeni optimist se UEFA do të vendosë në favor të Kosovës?***

F. Vokrri: Unë për nga natyra gjithmonë kam qenë optimist. Unë edhe si lojtar kurrë nuk kam hyrë në lojë me mendimin se mund të na mposhtin, por gjithmonë me faktin se ne mund t'i mposhtim. Kështu që, edhe në këtë drejtim, unë jam optimist se në UEFA do të mbizotërojë arsyeja reale që Kosovës në këtë fazë të paktën t'i lejohet të zhvillojë ndeshje miqësore. Megjithatë siç është vetë loja e futbollit me plot befasi, ashtu edhe organizmat e tjerë mund të kenë befasi. Por, neve na mban shpresa se ata do të vendosin në favorin tonë.

PAQJA: ***A mendoni se Kosova do të bëjë gara për Evropianin 2016, pasi për Botërorin 2014, ka mbetur jashtë?***

F. Vokrri: Siç e thashë më lart, anëtarësimi i FFK-s në këto mekanizma ka mbetur peng i çështjeve politike, siç ka mbetur edhe shteti i Kosovës pa u inkuadruar në OKB. Ne shpresojmë se kjo do të ndodhë shpejt, mbase gjatë këtij viti. Por gjithçka mbetet e varur edhe nga pranimi i Kosovës në OKB. Ne po e bëjmë punën tonë. Do të duhej që edhe politika ta bëjë të veten, me shpresa që të mos na kalojnë kualifikimet për evropianin 2016.

PAQJA: ***Nëse FIFA vazhdon ta mbajë të izoluar futbollin e Kosovës, a ka menduar FFK-ja për një ligë të përbashkët me Shqipërinë? A e lejon këtë FIFA?***

F. Vokrri: Shikoni, unë po dëgjoj shumë komente këto ditë dhe më duket se njerëzit po flasin me emocione, natyrisht si gjithë shqiptarët që duam një bashkim, por në rrethanat aktuale është tejet e vështirë për t'u realizuar, sepse duhet të jemi realë dhe pragmatikë. Dëshirat janë dëshira, e mundësitë janë tjetër. Pastaj aktualisht ne jemi dy shtete shqiptare dhe të gjithë këtu në Kosovë e kemi dashur Kosovën e pavarur. Unë mendoj se me kohë shumë gjëra do të vijnë në vend dhe në rend. A e lejon një gjë të tillë FIFA, këtë nuk mund ta them, sepse edhe ata besoj se do të gjendeshin para një akti të ri.

I kënaqur me MKRS-n dhe Bunjakun

PAQJA: ***A ka ndarë minsitira buxhet për FFK-në dhe sa jeni të kënaqur me ndihmën e MKRS-së?***

F. Vokrri: MKRS-ja nuk ndan paraprakisht ndonjë buxhet për federata, por sa herë që kemi shtruar projektet tona, sidomos në ndërkombëtarizimin e futbollit të Kosovës (në zhvillimin e takimeve dhe ndeshjeve), MKRS-ja na ka mbështetur fuqishëm. Por edhe në aktivitetin e brendshëm, MKRS-ja ka mbështetur edukimin e trajnerëve, gjyqtarëve si dhe klubet e femrave. Kështu që ne jemi të kënaqur me këtë bashkëpunim dhe mbështetje dhe shpresoj ta vazhdojmë këtë bashkëpunim.

PAQJA: ***Të flasim për reprezentacionin e Kosovës, sa jeni të kënaqur me punën e trajnerit Albert Bunjaku?***

F. Vokrri: Nga ajo që është punuar deri më tash, përzgjedhësi ka arritur një nivel të mirë të ndërtimit të ekipit përfaqësueses, por edhe nga plani i tij shihet qartë se jemi në ndërtim të përfaqësuesve jo vetëm asaj "A", por edhe të grupmoshave të tjera. Për këtë flet edhe kampi edukativ për moshat U-15, që u mbajt verën e kaluar si bazë e përfaqësueses. Përzgjedhësi, gjithsesi, ka një plan-program mjaft të avancuar të punës profesionale me Përfaqësuesen dhe mendoj se po përgatitemi mirë për arenën ndërkombëtare, duke përfshirë këtu futbollistët brenda dhe jashtë Kosovës.

PAQJA: ***Shumë futbollistë që kanë lindur në Kosovë dhe luajnë për shtete të tjera, a mund të luajnë për Kosovën?***

F. Vokrri: Për ne, futbollistët e Kosovës që luajnë nëpër klubet evropiane janë një thesar. Dhe kështu ne qysh tash kemi filluar që t'i inkuadrojmë ata, për aq sa po kemi mundësi reale, në radhët e përfaqësueses sonë. Gati në të gjitha ndeshjet e Përfaqësueses kemi të përfshirë shumicën e këtyre lojtarëve. E po ashtu, na gëzon edhe dëshira dhe përkushtimi i madh i tyre që të japin kontributin e tyre për Përfaqësuesen e Kosovës. Besoj dhe shpresoj se kjo do të vazhdojë. ■



MEDICINE HOSPITAL
INTERNATIONAL



Zemra juaj e sigurtë në duart tona

PËR HERË TË PARË NË KOSOVË ËSHTË HAPUR
KIRURGJIA E ZEMRËS

SPITALI SPECIAL PËR
SËMUNDJE KARDIOVASKULARE


MAGJISTRALJA PRISHTINË SHKUP,
PREOC, 10000 PRISHTINË

WWW.IMHKOSOVA.COM

MOB.: 044 936 720
TEL.: 038 500 601
FAX.: 038 500 601

AGORA
PIZZERIA

Për ushqim të shpejt dhe cilësor



AGORA PIZZERIA

Tel: 044-190-006

Prishtinë | Fushë Kosovë | Ferizaj | Podujevë